



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova


AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2018

Raporti për performancën e kompanive të licencuara të furnizimit me ujësjellës, shërbimeve të ujërave të ndotura dhe furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar

Korrik, 2019



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE.....	5
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË.....	6
1. HYRJE	7
2. ZHVILLIMET NË SEKTOR	8
3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU	10
3.1. FURNIZIMI ME UJËSJELLËS.....	10
3.2. SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA.....	24
3.3. PERFORMANCA FINANCIARE E KRU.....	32
3.4. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU	35
4. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT.....	42
4.1. UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UPF	42
4.2. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME	43
4.3. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA, QARKULLIMI DHE PARAJA E GATSHME E ARKËTUAR.....	43
4.4. SHPENZIMET KAPITALE PËR FURNIZIM ME UJËSJELLËS DHE SHËRBIME TË UJËRAVE TË NDOTURA.....	44
5. PERFORMANCA E N.H. "IBËR - LEPENCI"	46
6. AKTIVITETET E KKK.....	47
7. SFIDAT PËR TË ARDHMEN	48
SHTOJCA 1: KUALITETI I TË DHËNAVE.....	50
SHTOJCA 2: DEFINICIONET DHE ARSYESHMËRIA.....	67
SHTOJCA 3: PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	74
SHTOJCA 4: PASQYRAT TARIFORE (2018-2020)	77
SHTOJCA 5: PËRMBLEDHJE TREGUESISH-2018.....	78
SHTOJCA 6: TË DHËNA STATISTIKORE-2018.....	79
SHTOJCA 7: DETAJET KONTAKTUESE.....	80

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KNMU	Këshillit Ndërmintor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PMV	Plani i Monitorimit Vjetor
NJPM-NP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
PSCU	Plani për Sigurimin e Cilësisë së Ujit'
OBSh	Organizata botërore e shëndetësis
GNI	Grupi Ndërinstitucional (Qeveria, ARRU, KRU, SHUKOS).

FJALA HYRËSE

Të nderuar,

Përmes analizës krahasuese të ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit (shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit dhe një ndërmarrje për furnizim të ujit të pa trajtuar me shumicë), përmes vlerësimeve në arritjen e objektivave të aprovuara në biznes planet tre-vjeçare (2018-2020), si dhe përmes performancës së disa prej Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) në përmbushjen e nivelit të standardeve të shërbimit, është përpiluar ky Raport i cili paraqet performancën e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë për vitin 2018.

Shikuar në përgjithësi, në shumicën e Treguesve Kryesor të Performancës vërehet një përmirësim krahasuar me vitin 2017 sa i përket shërbimeve të cilat u ofrohen konsumatorëve.

Megjithatë vazhdon të jetë shqetësues fakti se dy prej treguesve kryesor të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve - Uji i pafaturuar dhe Shkalla e Arkëtimit, vazhdojnë të jenë në nivel jo të kënaqshëm. Uji i pafaturuar vazhdon të mbetet në nivel shumë të lartë edhe pse në këtë drejtim ka pasur angazhime nga ofruesit e shërbimeve përmes hartimit të strategjive, planeve të veprimit dhe aktiviteteve të ndërmarrja. Duke parë progresin shumë të ngadaltë të këtij fenomeni konsiderojmë se është i domosdoshëm koordinimi dhe angazhimi i të gjitha palëve me qëllim të përmirësimit të këtij treguesi.

Bazuar në analizimin dhe vlerësimin e hollësishëm të aplikacioneve, kemi përtërirë licencat për ofruesit e shërbimeve për periudhë tetë (8) vjeçare. ARRU ka monitoruar dhe në vazhdimësi do të monitorojë zbatimin e kushteve të licencës me theks të veçantë në nivelin e përmbushjes së standardeve minimale të shërbimit.

Përmes procesit tarifor 2018 -2020 i cili ka filluar së zbatuari nga Janari 2018, jemi kujdesur që të mbajmë ekuilibrin për tu siguruar konsumatorëve shërbime sipas standardeve të kërkuara, ofruesve të shërbimeve qëndrueshmëri financiare, duke pasur parasysh gjithmonë mbrojtjen e interesit të konsumatorëve.

Në kuadër të kompetencave tona, jemi angazhuar dhe do të vazhdojmë të angazhohemi në integrimin dhe konsolidimin e sektorit të shërbimeve, komunave dhe skemave tjera të ujësjellësve të cilat aktualisht nuk janë nën menaxhimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve.

Inkurajojmë dhe do të vazhdojmë të mbështesim ofruesit e shërbimeve për rritjen dhe përmirësimin e efijencës (reduktimin e shpenzimeve të pajustificueshme, rritjen e performancës në arkëtimin e të ardhurave dhe zvogëlimin e ujit të pa faturuar), zbatimin e programeve të investimeve për furnizim me ujë dhe trajtim të ujërave të ndotura, si dhe rritjen e nivelit të shërbimeve.

Informatat e dhëna në këtë raport mund të shfrytëzohen dhe do të jenë të dobishme nga të gjitha palët e interesuara për përcaktimin e prioriteteve, përpilimin e strategjive dhe planeve të veprimit, si dhe ndarjen e fondeve me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara në planet dhe dokumentet strategjike të shërbimeve të ujit.

ARRU do të vazhdojë të jetë e hapur dhe e gatshme për të mbështetur ofruesit e shërbimeve dhe të gjitha palët tjera me qëllim të përmirësimit të performancës së ofruesve të shërbimit e cila njëkohësisht nënkupton ngritjen e nivelit të shërbimeve të ujit.

Falënderoj stafin e ARRU dhe të gjithë përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve të ujit për bashkëpunim korrekt gjatë përgatitjes së këtij Raporti.

Me respekt

Raif Preteni, Drejtor i ARRU



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË

Si rregullator i pavarur, roli i ARRU qëndron në sigurimin e shërbimeve kualitative, të besueshme, dhe efikase të ujit pa diskriminim duke u përkujdesur njëkohësisht për mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

Përgjegjësitë funksionale të ARRU janë përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L -042, për rregullimin e shërbimeve të ujit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Dhjetor 2015. Në pajtueshmëri me këtë Ligj, Autoriteti raporton aktivitetet e tij dhe është llogaridhënës para Kuvendit të Kosovës. Për të arritur këtë rol ARRU bënë aktivitetet e saja kryesore:

- Përcakton tarifa që balancojnë nevojat e konsumatorëve me çmime të përballueshme dhe ruan integritetin financiar të ofruesve të shërbimeve,
- Licencon ofruesit e shërbimeve të furnizimit me ujë, duke siguruar që ata i përmbushin obligimet e tyre të ndërsjellta dhe të jenë në përputhje me kornizat tjera legjislative dhe politikat shtetërore në vend për sektorin e ujit,
- Nxit konkurrencën e sektorit të ujit përmes krahasimit (benchmarkingu) si dhe raportimit të rregullt të performancës, përmes monitorimit të kostove, investimeve, shërbimeve ndaj klientit dhe në përgjithësi standardeve të shërbimit,
- Mbron interesin e konsumatorëve duke siguruar që shërbimet që iu ofrohen atyre, të jenë në pajtim me standardet komerciale dhe teknike të përcaktuara me rregullat e ARRU,
- Siguron mekanizma adekuat për konsumatorët në lidhje me konsultimin dhe parashtrimin e ankesave ndaj ofruesve të shërbimeve.

Në pajtim me praktikën e mirë rregullatore, qasja e ARRU është e orientuar drejt rezultateve konkrete, kryesisht në lidhje me nivelet e shërbimit dhe shpenzimet e përgjithshme. ARRU nuk ndërhyrë drejtpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licencuar të shërbimeve.

ARRU gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tija, bashkëpunon ngushtë edhe me rregullatorët dhe institucionet e tjera vendore si:

- IKSHPK, përgjegjës për vendosjen e standardeve dhe monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, dhe në të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e ujit dhe veçanërisht në shkëmbimin e të dhënave për cilësinë e ujit, për këtë kemi bërë edhe një Marrëveshje Mirëkuptimi.
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me synimin për të siguruar që politikat dhe procedurat e ARRU, të mbështesin mjedisin dhe shëndetin publik.

1. HYRJE

Ne kemi parë një nevojë të qartë për informacion të besueshëm mbi evolucionin e sektorin të shërbimeve të ujit në Kosovë. Si për të mbështetur hartimin e politikave publike në këtë sektor, si dhe planifikimin strategjik nga ofruesit e shërbimeve, duke vlerësuar në mënyrë efektive shërbimet e ofruara për konsumatorët.

ARRU, si agjenci rregullatore për sektorin e ujit, filloi publikimin e 'Raportit Vjetor të Performancës së shërbimeve të ujit', që nga viti 2006, në mënyrë që t'i përgjigjen kësaj nevoje. Dhe kjo pra, është edhe njëra nga përgjegjësitë ligjore e autoritetit për të raportuar publikisht dhe në mënyrë të pavarur për performancën e ndërmarrjeve të ujësjellësve (neni 37, pika 5, ligji nr. 05/I -042, për rregullimin e shërbimeve të ujit).

Raporti i performancës 2018 për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë, vlerëson dhe krahason performancën e 7 Ndërmarrjeve rajonale të ujësjellësit që ofrojnë shërbime të ujit. Është raporti i dymbëdhjetë nga një seri e raporteve të performancës që prodhohet nga ARRU. Komentet dhe analizat në raport përfshijnë një sërë treguesish kyç të performancës dhe të tjerë, që mbulojnë: standardet e shërbimit, aspektet financiare, operative, shërbimin ndaj konsumatorëve dhe asetet e shërbimit. Të gjithë ofruesit e shërbimeve janë vendosur në një grupim, nuk janë ndarë sipas madhësisë apo ndonjë kriteri tjetër, ndonëse KRU 'Prishtina' është kompania më e madhe si për nga numri i konsumatorëve, prodhimit të ujit, apo edhe zonës së shërbimit. Rreth 40% e tërë zonës së shërbimit në vend, shërbehet nga kjo kompani, prandaj edhe si e tillë në kontekst të performancës ka avantazhet por edhe disavantazhet e saj. Sido që të jetë, performanca e saj ka ndikim të madhë në trendët e përgjithshme të zhvillimit të mbarë sektorit të shërbimeve të ujit në vend.

Komentet dhe analizat që përmban ky raport përveçse japin shpjegim gjithë përfshirës për secilin tregues të raportuar në nivel individual të KRU, përmban edhe mjaft diskutime nga trendët e zhvillimit ose dallimet mes tyre përgjatë viteve në nivel të sektorit. Pjesa më e madhe e informacionit vjen nga raportet e të dhënave të dërguara nga KRU, siç janë raporti vjetor dhe raporti periodik (tremujor), të dhëna tjera të siguruara edhe nga institucionet përgjegjëse si IKSHPK- të dhënat e kualitetit të Ujit, dhe nga ASK të dhënat për popullatën, inflacionin etj.

Të dhënat e mbledhura përmes sistemit të raportimit, auditohen/verifikohen në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre nga ana e ARRU. Ndonëse me një rezervë në shkallën e besueshmërisë sidomos të të dhënave operative dhe shërbimeve të konsumatorëve, konsiderojmë se ato janë të pranueshme për analiza të vlerësimit të performancës krahasuese vit pas viti.

Raporti ofron një analizë krahasuese të performancës së KRU për vitin 2018 në raport me vitin 2017. Më tej, analiza siguron vlerësimin e përgjithshëm të performancës duke renditur KRU dhe vlerësuar performancën e tyre në arritjen e treguesve kryesorë të performancës (TKP), në raport me objektivat dhe standardet e nivelit të shërbimit. Raporti po ashtu përmban edhe të dhëna statistikore, informacione, analiza, si dhe opinione për zhvillimet dhe sfidat e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Ne presim që ndikimet e analizës së përshkruar në këtë raport të jenë një referencë kyçe për Autoritetin dhe Bordet e Drejtorëve dhe Menaxhmentin Ekzekutiv të KRU, për të përmirësuar shërbimet e furnizimit me ujë dhe ujëra të ndotura në zonat e tyre përkatëse të shërbimit.

Shpresojmë gjithashtu që informacioni i dhënë në këtë raport do të jetë i dobishëm për palët e interesuara, organet qeveritare, donatorët dhe institucionet e tjera vendimmarrëse për marrjen e vendimeve të drejta dhe efektive, drejtë përmirësimit të mëtejshëm të këtij sektori, me ndikim në mirëqënien e qytetarëve, si dhe kontributin në qëndrueshmërinë mjedisore.

2. ZHVILLIMET NË SEKTOR

Licencimi i KRU (2018-2026)

Licencimi i kompanive të ujit është një ndër funksionet më të rëndësishme të procesit rregullator të cilin e zbaton ARRU. Me licencim veprimtaria e këtyre kompanive vendoset në suaza të rregullimit ligjor, duke iu nënshtruar kushteve dhe standardeve të përcaktuara me kornizën rregullatore. Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe gjithë dokumentacionit të kërkuar ARRU, ka vendosur për të ripërtërirë licencat për shtatë KRU-të dhe N.H. 'Iber Lepenci' në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh, duke filluar nga data 25 Shtator 2018 deri në datën 10 Shtator 2026. ARRU në vazhdimësi do të monitorojë zbatimin e kushteve të Licencës me theks të veçantë, lejet ujore dhe standardet minimale të shërbimit. Pra janë shtatë ndërmarrje publike nën mandatin rregullator për të ofruar shërbime të ujit (furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të ujërave të ndotura) dhe një ndërmarrje publike që ofron ujë me shumicë të patrajtuar për nevoja të ndërmarrjeve që furnizojnë me ujë të pijshëm.

Autoriteti Rregullatorë për Shërbimet e Ujit (ARRU), në pajtim me mandatin e vet ligjor të bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 i përtëriu licencat e shërbimeve për:

- KRU 'Prishtina' sh.a., Prishtinë
- KRU 'Hidrodrini' sh.a., Pejë
- KRU 'Gjakova' sh.a., Gjakovë
- KRU 'Bifurkacioni' sh.a., Ferizaj
- KRU 'Hidromorava' sh.a., Gjilan
- KRU 'Mitrovica' sh.a., Mitrovicë
- KRU 'Hidroregjioni Jugor' sh.a., Prizren
- Ndërmarrja Hidro-Ekonomike 'Ibër-Lepenci' sh.a., Prishtinë.

Të pa licencuara ende kanë mbetur ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që ofrojnë shërbime në komunat me komunitetin shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq). Jashtë integritimit në kuadër të kompanive të licencuara kanë mbetur po ashtu edhe një numër komunash përfshirë: Shtërpcën, Novo Bërdën, Parteshin, Kllokotin dhe Ranillugën, ndonëse ka gatishmëri të ndërsjellt (KRU-Komunë) për integrimin e tyre. Rehabilitimi i kushtëzuar i këtyre skemave është duke shkuar ngadalë, së këndejmi edhe integrimi i tyre është duke u vonuar.

ARRU, do të vazhdojë të përkrah konsolidimin e tyre dhe në përputhje me plotësimin e kushteve ligjore do të licencoj KRU respektive për të ofruar shërbime të ujit edhe në këto komuna.

Procesi tarifer(2018-2020)

Tarifat e reja për shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të ndotura për tre vitet e ardhshme 2018-2020, ka filluar së zbatuari nga KRU nga 1 Janari 2018. Biznes Planet finale të dakorduara konsiderohen si një kontratë në bazë të të cilave rregullatori është pajtuar me ato tarifa që bazohen në detyrimin e marrë nga KRU. Tarifat janë vendosur në mënyrë të tillë që ato të jenë të mjaftueshme për të përmbushur objektivat mjedisore, cilësore dhe të shërbimit të konsumatorëve të planifikuar nga ofruesit e shërbimeve të ujit (KRU).

Tarifat fikse (€/muaj) për konsumatorët shtëpiak për shërbimet publike të ujit kanë mbetur të njëjta që nga fillimi i përcaktimit të tyre (2005-2006) me nga 1.00 €/muaj, ndërsa konsumatorët jo-shtëpiak duke filluar nga viti 2018, janë ngarkuar me nga 2.00 €/muaj, për dallim prej 3.00€/muaj sa kanë paguar deri në 2017.

Tarifat vëllimore të shërbimeve të furnizimit me ujë për konsumatorët shtëpiak në nivel të sektorit kanë ndryshuar pak në krahasim me tarifën e vitit 2017, me nga 0.01 €/vit për gjatë 3 viteve të procesit tarifer 2018-2020, kurse tek konsumatorët jo-shtëpiak është bërë ulje e tarifave vëllimore si rezultat i uljes të shkallës së ndër - subvencionimit sektorial. ARRU ka sfiduar KRU përmes vendosjes së objektivave në parametrat të cilat kanë implikime në tarifa siç janë: (i) Shpenzimet operative, me të cilat janë nxitur ofruesit e shërbimeve që të zvogëlojnë ato ku ekzistojnë mundësitë; (ii) Ofruesit e shërbimeve, janë sfiduar me parametra të matshëm në reduktimin e sasisë së ujit të humbur nga 2% për çdo vit të procesit tarifer; me fokus në

humbjet komerciale (kyçjet e paligjshme dhe aktivitetet jo efikase të faturimit): Si dhe (iii) më shumë kompanitë, janë sfiduar me efikasitetin e arkëtimit në nivelin 100%, për konsumatorët jo-shtëpiak, dhe për konsumatorët shtëpiak përmirësime nga 3% për çdo vit, të procesit tarifor aktual. Pra ne presim nga ofruesit e shërbimeve: rritjen edhe përmirësimin e efikasitetit të përgjithshme (reduktimin e shpenzimeve të pajustificueshme operative, rritjen e performancës në faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave, zvogëlimin e ujit të pa faturuar), zbatimin e programeve të investimeve për furnizim me ujë dhe trajtim të ujërave të ndotura, si dhe rritje të nivelit të shërbimeve, përfshirë edhe rritjen e numrit të konsumatorëve (mbulueshmërinë me shërbime) në furnizim me ujë, grumbullim dhe trajtim të ujërave të ndotura.

Konsolidimi dhe integrimi sektorit të shërbimeve të ujit

Edhe në vitin 2018, Qeveria e Kosovës ka vazhduar në mënyrë intensive të adresojë çështje të rëndësishme për sektorin e shërbimeve të ujit. Në kuadër të Këshillit Ndërmintor për Ujërat (KNMU)¹, janë ndërmarrë disa vendime të rëndësishme si dhe janë dhënë konkluzione për ministritë e ndryshme me përgjegjësi në sektorin e ujit.

Qeveria e Kosovës me vendimin e datës: 10 Janar 2018 edhe një herë ka konfirmuar zotimin për konsolidimin e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit, sipas vendimit më të hershëm në mbështetjen e korporatizimit si dhe mundësinë e konsolidimit të mëtejshëm, varësisht nga kërkesa e tregut dhe parimin e menaxhimit të resurseve ujore mbi konceptin e rajoneve të pellgjeve lumore. Kompanitë e ujësjellësve në pjesën veriore të Kosovës, duhet të konsolidohen dhe licencohen nga ARRU. Po ashtu edhe njësitë operative të ujësjellësve nga komunat të cilat kanë mbetur jashtë menaxhimit të KRU, duhet të konsolidohen dhe integrohen në KRU respektive në kuadër të zonave përkatëse të shërbimit. Me datë 07 Dhjetor 2018, Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga MZHE dhe ARRU të fillojnë me integrimin e komunave, Hani i Elezit dhe Shtëpcës në KRU 'Bifurkacioni'.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU, për shkak të refuzimit të tyre.

Në Mitrovicën veriore vazhdon të operojë pa licencë ofruesi i shërbimeve NPK "Vodovod Ibar". ARRU në vazhdimësi ka bërë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi përmes procedimit të letrave dhe paralajmërimeve konform Ligjit nr. 05/L-042, Megjithatë nuk kemi pasur asnjë përgjigje pozitive, ARRU ka iniciuar procedurë gjyqësore në vitin 2014 - akoma jemi në pritje të vendimit të gjykatës.

Komunat Shtëpcë, Novo Bërd, Partesh, Klokot, Ranillug dhe Hani i Elezit, planifikohet të integrohen në kompanitë rajonale përkatëse, pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre. Rehabilitimi është planifikuar përmes investimeve të fazës së V-të të projektit të SDC (investim i Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicërene). Marrëveshjet me komunat përkatëse janë nënshkruar dhe integrimi do të bëhet pas pranimit teknik të punëve. Sipas donatorëve të involvuar në këtë proces, punët do të përfundojnë në fund të gjashtëmujorit të parë të viti 2019.

Procesi tashmë ka filluar nga KRU 'Hidromorava', me marrjen nën menaxhim të disa vendbanimeve të Komunës së Parteshit dhe Novodërdës, përderisa KRU 'Bifurkacioni' ka marrë nën menaxhim një pjesë të aseteve të ujit nga komuna e Hani të Elezit, duke ofruar shërbime për një pjesë të popullatës së kësaj komune. Këto dy kompani duhet të bëjnë kërkesë formale tek ARRU, për ndryshimin e licencës për shërbime për të përfshirë edhe komunat e më sipërme në zonën e integruar të shërbimit të tyre. Autoriteti do të lëshojë licencë për shërbime vetëm pasi të plotësohen kriteret e parapara me ligj dhe rregulloren Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

¹ Sipas dispozitave të ligjit për ujërat (nenet 15), "KNMU është trup koordinues dhe vendim-marrës që shqyrton çështjet sistemore të ujërave, që merret me harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e rezervave të ujit dhe sistemit të Kosovës".

3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU

3.1. FURNIZIMI ME UJËSJELLËS

Ky kapitull ofron analizën dhe vlerësimin e performancës teknike, financiare dhe shërbimeve të konsumatorëve të ofruar nga KRU në furnizimin me ujë në nivel të sektorit, si dhe në rrafshin individual. Analiza mbulon: (i) standardet e shërbimit (cilësinë e ujit, presionin në rrjetë, vazhdimin e furnizimit me ujësjellës), (ii) aspektet operative (plasjen e gypave, UPF, matjen e ujit), (iii) shërbimeve ndaj konsumatorëve (mbulueshmërinë me shërbime, matjen e ujit, ankesat), si dhe (iv) aspektet financiare (volumin dhe vlerat e shitjeve si dhe kostot njësi të prodhimit dhe furnizimit).

3.1.1 Përformanca jo-financiare (teknike)

Cilësia e ujit

Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm bëhet në bazë të UA 16/2012, dhe rregulloreve tjera të dala prej saj, të cilat kanë instaluar një program të hollësishëm dhe të gjerë të frekuencës dhe vend marrjes së mostrave për ujë, dhe aspekteve tjera të cilat lidhen me monitorimin e cilësisë së ujit në të gjitha sistemet e furnizimit dhe shpërndarjes. Këto aranzhime të monitorimit kontrollohen nga IKSHPK-QU që është institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin ekstern të cilësisë së ujit të pijshëm dhe i cili siguron se uji i distribuuar nga KRU, është në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore të cilësisë së ujit. Në këtë raport, vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.




Fig.1. Kualiteti i ujit për vitet 2017 dhe 2018

Gjatë kësaj periudhe raportuese (2018) janë marrë 8,598 mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. Prej tyre, 99,4 % e mostrave kanë qenë në përputhje me standardet vendore të cilësisë së ujit. Në aspektin bakteriologjik janë testuar më tepër mostra, gjithsejtë 6,007 sosh dhe 99.3% e tyre kanë qenë në përputhje me vlerat parametrike të lejuara. Në aspektin e cilësisë fiziko-kimike, janë testuar 2,591 mostra dhe 13 sosh apo 99.5% rezultuan të jenë në përputhje me vlerat e lejuara.

Referuar këtyre statistikave, cilësia e ujit e furnizuar nga KRU është në nivel shumë të mirë. Një përmbledhje e statistikave (normave) të cilësisë së ujit të furnizuar në 2018, sipas KRU është dhënë në tabelë nr.1, më poshtë.

Tab.1, Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2018

Testet	Prishtina	Hidroregjioni Jugor	Hidrodrini	Mitrovica	Gjakova	Bifurkacioni	Hidromorava	Sektori
	2018	2018	2018	2018	2018	2018	2018	2018
Mikrobiologjike	100%	99.7%	98.7%	99.6%	99.7%	97.1%	98.3%	99.3%
Fiziko-Kimike	98.9%	99.4%	100%	100%	100%	98.2%	99.4%	99.5%
Mesatarja për KRU	99.7%	99.6%	99.1%	99.7%	99.8%	97.4%	98.8%	99.4%

IKSHPK, është angazhuar dhe ka paralajmëruar për avansimin, gjegjësisht azhurnimin e UA 16/2012, në frymën e kërkesave të fundit të Direktivës Evropiane dhe Rekomandimeve të OBSH, në lidhje me 'Planin për Sigurimin e Cilësisë së Ujit' (PSCU) me të cilin do të vlerësohet dhe menaxhohet risku, si dhe do të definohen edhe mëtej përgjegjësit institucionale të autoritetit shëndetësor (IKSHPK) dhe O.SH, në lidhje me: **Monitorimin operacional** dhe **Monitorimin e pajtueshmërisë së cilësisë së ujit në rubinetën e konsumatorëve**. Kjo do të jetë një kontribut dhe angazhim më tej në aspektin e sigurisë së cilësisë së ujit, ofruar konsumatorëve dhe popullatës.

Presioni i Ujit

Ky tregues, pasqyron përqindjen mesatare të pronave të lidhura që kanë furnizim me ujë e që, në rrethana normale, nuk mund të kenë një presion të garantuar të ujit në rubinetet e tyre prej 1.5 bar -7 bar.




Fig.2, Përqindja e pronave të cilat kanë probleme me presion të ulët

Në vitin 2018, vetëm KRU 'Hidromorava ka raportuar 100 prona që merrnin presion / rrjedhë nën nivelin referent. Kjo korrespondon me 0.19%, të mesatarës dy vjeçare (të pronave të lidhura në KRU 'Hidromorava').

Siç shihet edhe nga Fig.2, te shumica e kompanive, nuk janë shfaqur probleme në sigurimin e presionit në rrjetin shpërndarës.

Në këtë rast duhet përfshirë KRU 'Mitrovica', e cila ka një shtrirje më të madhe të manometrave dhe të instalimit të SCADA sistemit të monitorimit (rreth 60% e zonës së shërbimit), permanent on-line. Kompanitë e tjera monitorimin e presioneve në rrjetin shpërndarës e bëjnë në mënyrë të kufizuar dhe në disa raste sipas ankesave apo kërkesave të konsumatorëve. Asnjëra nga KRU, nuk ka mundur të sigurojë të dhëna plotësisht të besueshme sa i përket matjes së presionit të ujit edhe pas shumë vitesh analize të këtij treguesi, prandaj ARRU është e kufizuar në besueshmërinë e këtyre të dhënave dhe rrjedhimisht të këtij treguesi.

Kompanitë duhet monitoruar dhe siguruar informacione të besueshme për presionet në gypat e tyre të shërbimit, dhe atë për tërë zonën e shërbimit, duke vendosur zonat e menaxhimit të presioneve me numër të mjaftueshëm të pikave matëse (manometrave), si dhe vendosjen e një sistemi On-line të monitorimit dhe testimit të matjes së presionit.

Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës

Besueshmëria e shërbimit përfaqëson njërin nga standardet e rëndësishme të shërbimit, e cila paraqet përqindjen e pronave të shërbyera në vazhdimësi me ujë të ndarë në tre kategori: prona që kanë furnizim 24 orë, 18-23 orë furnizim dhe prona që kanë më pak se 18 orë furnizim, duke përfshirë rastet e veçanta që mund të ndodhin siç janë: ndërprerjet për shkak të

problemeve teknike që ndodhin në teren apo ndërprerje për punë të planifikuara të Kompanisë.




Fig.3. Norma (%) e konsumatorëve me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm

Vazhdimësia e furnizimit me ujë, edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar të shënojë progres. Orët mesatare të furnizimit me shërbime të ujësjellësit në ditë nga KRU në nivel sektori në 2018, është 23.9 përgjatë 24 orëve. KRU, të cilat kanë raportuar se furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU 'Gjakova', 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica'.

Edhe përkundër kapaciteteve të mjaftueshme për të furnizuar pa ndërprerje konsumatorët e saj në kuadër të zonës së shërbimit KRU 'Prishtina', ende ka probleme sa i përket furnizimit të rregullt, në një pjesë të komunës së Fushë Kosovës, kryesisht lidhur me aspektin teknik. Reduktime po ashtu janë aplikuar edhe nga KRU 'Bifurkacioni' për rreth 2,100 konsumatorë, kryesisht në disa zona rurale të shërbyera nga kjo kompani.

Viteve të fundit janë realizuar investime të konsiderueshme në ngritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit, në disa prej kompanive të cilat në mënyrë kronike patën vuajtje nga mungesa e tyre. KRU 'Hidromorava' dhe 'Bifurkacioni', duhet të mendojnë edhe më tej në planet afatgjate të furnizimit dhe gjetjen e burimeve të sigurta të ujit. Aktualisht burimet ekzistuese të tyre nuk janë të mjaftueshme, si dhe janë shumë të cënueshme nga thatësitrat.

Plasaritjet e Gypave

Ky tregues paraqet numrin total të plasaritjeve të gypave gjatë vitit për 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit (duke përfshirë gypat e shërbimit të kyçjes).




Fig. 4. Plasjet e gypave të furnizimit me ujësjellës

Numri i raportuar i defekteve në rrjetin e ujësjellësit gjatë vitit 2018 për 100 km varjojnë nga 573 plasje/defekte në KRU 'Hidroregjionin Jugor', deri në rastin më të mirë tek KRU 'Prishtina' me 98 plasje në 100 km rrjet. Investimet e konsiderueshme nga KRU 'Prishtina' edhe në infrastrukturë (rrjeta/gypat e ujësjellësit), duhet rezultuar me një zhvillim pozitiv në këtë tregues.

Mesatarja e sektorit në mbarë vendin gjatë vitit 2018 kap vlerën prej 208 plasje për 100 km gypë të rrjetit të ujësjellësit. Edhe pse është një trend pozitiv (zvogëlimi i numrit të defekteve) nga viti i kaluar, ende kjo është një normë shumë e lartë dhe jashtë standardeve dhe praktikave të mira të menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë.

Në këtë rast, vjetërsia e gypave si dhe mungesa e mirëmbajtjes adekuate nga ana e KRU, janë faktorët kryesor për performancën e dobët të rrjetit të ujësjellësit. Menaxhmenti i KRU-ve, duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të pranoj se shumica e infrastrukturës-rrjetit të ujësjellësit ka nevojë për investime të konsiderueshme në rehabilitim dhe mirëmbajtje. Kjo do të ishte e mundur vetëm me një plan të mirë të menaxhimit të aseteve, me refleksione pozitive në reduktimin e humbjeve të ujit dhe cilësinë e shërbimit.

Uji i pa-faturuar

Uji i Pa-faturuar (UPF), është ndryshimi në mes të sasisë së ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në rrjet në raport me sasinë e ujit të faturuar, përndryshe është një sasi e ujit e cila nuk sjell të ardhura për KRU.




Fig. 5. Norma e UPF (%)

KRU po tregojnë një ritëm të ngadaltë në reduktimin e UPF. Në vitin 2018 vlerësohet se përafërsisht 58% e ujit të trajtuar humbnin nga rrjedhja dhe keqpërdorimet e konsumatorëve. Në nivel mesatar nuk ka ndonjë zhvillim nga viti i kaluar norma e UPF mbetet e njëjtë. Përfunduar KRU 'Prishtina' dhe 'Bifurkacioni', kompanitë e tjera kanë shënuar progres, në zvogëlimin e UPF përgjatë këtij viti vlerësues.

Shenim: Për KRU 'Prishtina' sasia e ujit të prodhuar është marrë 54,569,918 m³, dhe KRU 'Bifurkacioni', 8,982,618 m³, vlera të gjetura nga aktivitetet e Inspektimit.

Një normë referimi e pranueshme ndërkombëtarisht që edhe ARRU e ka adoptuar si objektive të synuar, sygjeron që UPF të jetë me e vogël së 25% dhe pa përjashtim asnjë nga KRU, nuk janë afër këtij objekti.

Për më tepër, objektivat për zvogëlimin e UPF nga ana e KRU janë pjesë e proceseve tarifore vit pas viti. Për vitin 2018 caku i reduktimit të UPF në nivel sektori ka qenë 51% dhe kjo nuk ka mundur të arrihet. Objektivat individuale po ashtu nuk kanë mundur të përmbushen nga asnjëra KRU, përjashtuar KRU 'Gjakova', e cila si e vetme ka arritur objektivin me parë të planifikuar prej 44% për vitin 2018.

Rezultatet e vlerësuara të UPF, në terma si: përqindje e prodhimit të ujit (realizuar-planifikuar), litër për konsumator në ditë dhe si vlerë vëllimore vjetore për secilën KRU, janë paraqitur në Tab. 2, në vijim:

Tab.2, Vlera e UPF në disa prej treguesve

KRU	UPF(%)-realizuar	UPF(%)- planifikuar	UPF (l/kons./ditë)	UPF mil.m3
Prishtina	60%	51%	692	32.7 mil.m3
Hidroregjioni Jugor	57%	53%	561	9.7 mil.m3
Hidrodrini	62%	57%	925	15.7 mil.m3
Mitrovica	59%	50%	1,491	16.8 mil.m3
Gjakova	44%	44%	488	6.5 mil.m3
Bifurkacioni	63%	44%	568	5.6 mil.m3
Hidromorava	53%	45%	428	4.5 mil.m3

Kjo sfidë e KRU është adresuar edhe nga Institucionet përgjegjëse (Qeveria e Kosovës dhe ARRU), duke kërkuar që ato përmes hartimit dhe zbatimit të strategjive adekuate ti reduktojnë në mënyrë efektive humbjet e ujit.

Aktivitetet e KRU për reduktimin e UPF, janë duke vazhduar dhe zbatimi i planit të veprimit të detajuar në planet strategjike të kompanive kanë marrë mbështetje nga Grupi Ndërinstitucional(GNI). Përmirësimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve të zbulimit të rrjedhjeve, si dhe instalimi i ujëmatësve, janë disa nga aktivitetet që janë duke u ndërmarrë nga kompanitë. Është e njohur se KRU ende e kanë në menaxhim një pjesë të madhe të sistemit me infrastrukturë shumë të vjetër që do të kërkojë investime të rëndësishme për modernizimin e sidomos të rrjetave të ujësjellësit.

KRU duhet të aplikojë një qasje më të mirë për menaxhimin e aseteve (shpenzimet kapitale në rrjetin, menaxhimi efektiv i aseteve) dhe veprime të vazhdueshme në zbulimin e konsumit ilegal nga konsumatorët e pa përgjegjshëm. Kjo do të jetë një praktikë e sigurt e drejtarritjes së një nivel të qëndrueshëm dhe ekonomik të UPF. Nevoja për të zbatuar planin e veprimit nga strategjia individuale të KRU për reduktimin e UPF, është më se e domosdoshme, dhe ARRU do të vazhdojë të monitorojë shumë ngushtë zhvillimet në këtë drejtim. Ne jemi duke punuar me KRU që të zbatojnë edhe Modulin e Bilancit të Ujit, si një mjet thelbësor për vlerësimin, dhe identifikimin e sasisë së ujit të UPF.

Aktiviteti i auditimit, krahas atij të inspektimit të realizuar nga ARRU në vitin 2018, ka identifikuar se besueshmëria e të dhënave për ujin e prodhuar është ende e ulët në disa prej KRU. Kjo ka reflektim të drejtpërdrejt përveç tjerash edhe në vlerësimin objektiv të UPF, prandaj ARRU edhe në këtë rast kërkon nga KRU, të cilat kanë ende burime të ujit në të cilat nuk

kanë ujëmatësa, apo janë jo funksional, të vendosin ujëmatësit dhe pajisjet tjera të cilat garantojnë vlera të sakta të prodhimit të ujit.

3.1.2 Performanca jo-financiare (komerciale)

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Duke pasur parasysh se regjistrimi i fundit i popullatës nga ASK është bërë në vitin 2011 dhe rritja e popullatës që nga ky vit kullohet në bazë të koeficientit të përcaktuar nga ASK, duke pasur parasysh realitetin nga terreni të lëvizjeve të popullatës nga zonat rurale në zona urbane, zhvillimin e madh në zonat urbane me theks ndërtesat e banimit kolektiv – dukuri kjo që ka shkakuar rritjen enorme të numrit të konsumatorëve të shërbyer brenda zonës së shërbimit, analizimi/ kalkulimi i mbulueshmërisë me shërbime në vijim të këtij Raporti është pasqyruar nga tri këndvështrime/versione.

Në pjesën e parë (fig.6) - kalkulimi i mbulueshmërisë me shërbime është bazuar në Planin e Monitorimit Vjetor i cili këtë tregues e definon si Mesatarja e vitit të analizës dhe vitit paraprak “të numrit të konsumatorëve shtëpiak të furnizuar me ujë në fund të vitit në raport me e numrin e përgjithshëm të konsumatorëve shtëpiak në zonën e shërbimit në fund të vitit, ku:

- Numri i konsumatorëve shtëpiak të shërbyer nënkupton numrin e faturave të lëshuara nga KRU,
- Numri i konsumatorëve në zonën e shërbimit është kalkuluar në vitin 2011 në bazë të ekonomive familjare të raportuara nga ASK dhe në vitet më pas numri i ekonomive familjare është kalkuluar në bazë të një koeficienti të sygjeruar nga ASK.

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujësjellës është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujësjellës nga KRU, përmes rrjetit publik të furnizimit .




Fig.6, Norma (%) e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit nga KRU

Në figurën 6, është paraqitur progresi në mbulueshmërinë me shërbimet e ujësjellësit për shtatë kompanitë e ujit dhe mesataren e sektorit, gjatë vitit 2018 në raport me vitin 2017.

Në terma të ekonomive familjare, mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës gjatë vitit 2018 në nivel sektori arrin shkallën prej 97% e që është për 3% më e lartë se sa në vitin paraprak 2017.


Duke pasur parasysh faktet e përmendura më lart (regjistrimi i fundit në vitin 2011, lëvizjet e popullatës, ndërtime të mëdha në zonat urbane, etj), ARRU ka kërkuar nga Projekti ‘Mbështetja për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Kompanitë Rajonale të Ujit në Kosovë’, i cili është pjesë integrale e Programit Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale në Kosovë - Faza e VI, bashkë-financuar nga Qeveria e Kosovës dhe Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, menaxhuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë, që gjatë vlerësimit të “Përputhshmërisë me Kushtet e Licencës nga Ofruesit e shërbimeve”, të analizojë më detalisht këtë tregues. Bazuar në të dhënat e dala nga ky aktivitet, lidhur me mbulueshmërinë me shërbime të ujit rrjedh se shtatë ofruesit e shërbimeve janë të licencuar për të siguruar ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për gjithsej 29 komuna. Me që komuna e Mamushës gjatë vitit 2018 nuk

ka pasur shërbime të ujësjellësit, rrjedhimisht gjatë vitit 2018 shërbime të ujësjellësit nga ofruesit e licencuar të shërbime janë ofruar në 28 komuna.

Në këtë analizë të dhënat sa i përket lokacioneve, emërtimeve dhe numrin e popullatës së vend-banimeve, janë huazuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa të dhënat e vend-banimeve që kanë qasje publike në shërbimet e ujit e që menaxhohen nga Ofruesit e licencuar të shërbimeve, janë bazuar në Modulet e faturimit të ofruesve të shërbimeve.


Në terma të vend-banimeve të këtyre komunave, në nivel të sektorit janë 557 vendbanime nga gjithsej 1,228 të cilat kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga 7 Ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Shtirja e shërbimeve të ujësjellësit në vendbanime, 2018



Në terma të numrit të banorëve, në nivel të sektorit, shtatë Ofruesit e shërbimeve të ujit sigurojnë shërbime të ujësjellësit tek 73% e popullatës, në gjithsej 28 komunat përkatëse.

Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit, 2018



Siç edhe shihet më lart, për analizimin real të përqindjes së mbulueshmërisë të popullatës me shërbime, faktor kyç i kalkulimit është numri i banorëve dhe ekonomive familjare (të dhëna këto të cilat aktualisht janë të kalkuluara në bazë të regjistrimit të vitit 2011). Me qëllim të paraqitjes së saktë të këtij treguesi shpresojmë që në afat sa më të shkurtë kohor të kemi informatat e sakta të cilat do të jenë të bazuara në regjistrimin e popullatës nga ASK. Ndërkohë ARRU në bashkëpunim me të gjitha palët do të vendosë për versionin më të arsyeshëm të matjes së performancës së këtij treguesi për vitet në vijim.

[Matja e ujit](#)

Matja e ujit të konsumuar është një prej standardeve të rëndësishme të shërbimit të ujit, është parakusht për të ngarkuar konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real. Ujëmatja gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.




Fig.7, Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës(%)

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në përqindje, paraqet numrin e konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve aktiv të shërbyer. Raporti i matjes së ujit është përmirësuar nga 93% në 2017 në 95% në 2018 apo për 2%. Si do që të jetë performancë më të mirë tek pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2018 në raport me vitin paraprak 2017, kanë shënuar të gjitha KRU. Në vitin 2018 nga të gjitha KRU janë raportuar mbi 13,927 ujëmatës të rinj të vendosur vetëm për kategorinë e amvisërisë.

Standardi ligjor i nivelit të shërbimit për matjen e ujit, kërkon nga KRU që faturimin e të gjithë konsumatorëve të tyre ta bëjë përmes ujëmatësve funksional dhe të verifikuar në aspektin e saktësisë. ARRU nuk është i kënaqur me këtë normë aktuale por edhe me një përmirësim kaq të vogël, vazhdimisht ka kërkuar nga KRU që të kenë përmirësim më dinamik në këtë tregues, veçanërisht nga KRU 'Mitrovica' dhe 'Hidromorava'.

Menaxhmenti i kompanive duhet të njohin rëndësinë e matjes së saktë, si nga pikëpamja e rikuperimit të të ardhurave nga faturimi dhe ndoshta edhe më e rëndësishmja, identifikimi se ku ndodhin humbjet e ujit. Për shkak të konsumit të rregullt dhe vjetërsisë, ujëmatësit ngadalësohen apo shpejtohen dhe bëhen më pak të saktë me kalimin e kohës. Është realitet për momentin se shumica dërrmuese e ujëmatësve në vend janë në shërbim për rreth 10-15 vjet apo më shumë. Ujëmatësit duhet të mirëmbahen dhe zëvendësohen sipas një programi zbatues nga KRU. Një mbulueshmëri më e lartë e konsumatorëve me ujëmatës, kompanisë do ti ofronte mundësinë që të bëjë menaxhimin më të mirë të humbjeve fizike dhe uljen e nivelit të keqpërdorimit, e cila do të ndikonte padyshim edhe në parandalimin e humbjeve financiare të kompanive.

Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin se sa janë të kënaqur konsumatorët në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Fig.8, e ilustruar si më poshtë pasqyron numrin e ankesave të regjistruara teknike dhe komerciale në total ndaj shërbimit të ujit, pavarësisht mënyrës së parashtrimit nga ana e konsumatorit dhe me to është shprehur pakënaqësia në lidhje me ndonjë veprim jo të drejtë apo mos veprim nga ana e kompanisë.



Fig. 8, Numri i ankesave për shërbimet e ujësjellësit

Numri i ankesave të paraqitura nga ana e konsumatorëve si atyre teknike dhe komerciale për shërbimet e ujit gjatë vitit 2018, kanë shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 3,318 ankesa apo shprehur në përqindje 17%.

Numri i ankesave për shërbimet e ujit gjatë vitit 2018 në total arrin vlerën 16,441, ku prej tyre 9,235 janë ankesa të natyrës teknike, ndërsa 7,206 janë ankesa komerciale që kanë të bëjnë me kontestimet e borxhit dhe ndërprerjet e faturimit.

Shumica e ankesave teknike janë paraqitur për rrjedhje në rrjetin e ujësjellësit e cila e dhënë na jep një pasqyrë të qartë se i gjithë problemi është dështimi i rrjetit të ujësjellësit. Ankesat teknike, kryesisht kanë të bëjnë me furnizimin jo të rregullt, ndërprerjeve dhe defekteve të shpeshta në rrjetë, si dhe kualitetin e ujitpërderisa ankesat e natyrës komerciale më tepër janë për shkakun e kontestimit të saktësisë së faturimit dhe mënyrës së faturimit (faturimi paushall, faturimi në banesa kolektive,etj).

Autoriteti ka ndarë një notë të ulët të besueshmërisë për të dhënat e ankesave të konsumatorëve. Shumica e kompanive kanë aplikacione softuerike - module përkatëse (CRM), por ato nuk janë të përditësuara. Ankesat ende mbahen në ditar-formate të Excelit dhe të shpërndara tek disa KRU, në departamente të ndryshme të kompanisë.

KRU-të duhet të mbajnë një regjistër të përditësuar dhe unik të ankesave të konsumatorëve dhe ato ti zgjidhin brenda një afati kohor të përcaktuar me ligj, sipas Rregullores për standardet minimale të shërbimeve.

3.1.3 Performanca financiare

Volumi i ujit të shitur

Ky tregues paraqet volumin e ujit të shitur të realizuar në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç janë përcaktuar në aplikacionet tarifore të KRU gjatë procesit tarifor aktual (2018-2020).




Fig.9. Normat sasiore për ujin e shitur nga KRU në raport me vlerësimet sipas planit të biznesit

Në nivel sektori shitjet volumetrike të realizuara në raport me ato të planifikuara kanë shënuar performancë më të mirë nga 87% sa ishin gjatë vitit 2017 në 94% në vitin 2018. Në rastin më të mirë KRU 'Mitrovica' dhe 'Gjakova' kanë tejkaluar cakun e planifikuar të shitjeve.

Për vitin 2018 nga të gjitha KRU janë planifikuar të shiten mbi 64 milion m³ ujë, përderisa kanë arritur të realizojnë mbi 66 milion m³, që do të thotë për 2 milion m³ më tepër realizim apo shprehur në përqindje 3%.

Rritjen e planifikimeve të shitjeve të ujit në biznes planet e KRU ishin arsyetuar me projeksionet për rritjen e lidhjeve të konsumatorëve dhe mbulimin e vazhdimësisë së furnizimit. Kjo performancë e mirë e KRU për realizimin e shitjeve të ujit padyshim se do të ndikojë në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për nevojat financiare të KRU, në veçanti për financimin e investimeve kapitale.

Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale, duke krijuar vetë qëndrueshmërinë financiare.

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor 2015-2017(viti 2017) dhe për procesin tarifor 2018-2020 (viti 2018).




Fig.10. Norma e vlerës së shitjeve të furnizimit me ujësjellës (EUR), në raport me shitjet e planifikuara

Gjatë vitit 2018 vlera e shitjeve gati në të gjitha KRU, në përjashtim të KRU “Hidromorava”, ishte më e lartë se sa vlera e planifikuar e shitjeve. Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2018 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte 30.1 mil.€ ndërsa ajo e planifikuar rreth 32.2 mil.€ do të thotë se 93% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është me e lartë për 6% krahasuar vitin 2017 që ishte 87%.

Sa i përket performancës së shitjeve në nivel të kompanive, për dallim nga viti i kaluar ku KRU “Hidromorava” printe me përqindjen më të lartë të caktuar të arritur, këtë vit ajo mbetet me normën më të ulët të realizimit prej 88%, njëherit me një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2017, përderisa KRU “Mitrovica” jo vetëm që ka arritur ta këtë përmirësimin më të lartë dhe të prijë në raport me kompanitë e tjera prej 108%, ajo madje ka arritur ta tejkalojë cakun e saj të planifikuar 8%.

Mos realizimi i shitjeve të ujit, deri në nivelin e planifikimit para së gjithash është rezultat i jo efikasitetit të KRU për të rritur shitjet sasiore, por një pjesë mund ti atribuohet edhe zvogëlimit të prodhimit i cili në vitin e shqyrtuar ka qenë më i ulët se sa në vitin paraprak .

Vlera relative e shitjes në 2018 në raport me 2017




Fig. 11, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujësjellës gjatë 2018 në raport me vitin 2017(%)

Nga figura 11, vërehet së nga shtatë kompanitë, pesë prej tyre kanë treguar progres tek shitjet gjatë periudhës raportuese 2018 në raport me vitin 2017.

Këtë vit për dallim nga shitjet e planifikuara ku KRU “Hidromorava” mbetet kompania me arritjen e caktuar më të ulët në raport me kompanitë e tjera, tek shitjet e realizuara në raport me vitin paraprak 2017 prin me përqindjen më të lartë dhe atë me një ngritje prej 5.63%, rezultat i të cilës ka qenë rritja e numrit të konsumatorëve të kyçur në shërbimin e ujësjellësit për 12%, duke reflektuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike për 5%.

Shitjet në nivel sektori në 2018 janë më të larta për 0.98% në raport me vitin 2017 si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike për 0.1% .

Kostot për njësi² e ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë së cilës kuptojmë shpenzimet për një m³ të ujit të prodhuar.

² Kostot për njësi për vitin paraprak 2017 janë të rregulluara për normë të inflacionit 1.02




Fig. 12. Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2018 në raport me vitin 2017(€/m³)

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2018, në terma reale ka shënuar një rritje marginale prej 0.003€/m³ nga 0.046 €/m³ sa ishte në 2017 në 0.048 €/m³ 2018.

Kostoja e prodhimit të ujit më e ulëta, varjonë nga 0.006€/m³ tek KRU “Hidrodrini”, deri tek ajo më e larta në 0.09€/m³ në KRU “Hidroregjioni Jugor”. Kostoja e prodhimit ndikohet kryesisht nga lloji i sistemit të furnizimit, p.sh furnizimi me gravitet është më i lirë të operohet se sa sistemi me pompa po ashtu edhe burimi me cilësi më të mirë të ujit të pa përpunuar, zvogëlon dukshëm shpenzimet e prodhimit siç është rasti të KRU “Hidrodrini” .

Kostoja e lartë e ujit të prodhuar tek KRU “Hidroregjioni Jugor” edhe këtë vit sikurse vitet e kaluara është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit, në veçanti nga shpenzimet e larta të energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave (822,723 € ose 53% janë shpenzimet e energjisë dhe derivateve në raport me shpenzimet totale të ujit të prodhuar).

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujësjellës.

Paraqet shpenzimet totale, përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë, përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Fig. 13. Kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës,(€ për m³ ujë të shitur)

Në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës ishte 0.44 € për m³ dhe është më e lartë për 0.04 €/m³, krahasuar me vitin paraprak 2017.

KRU 'Hidrodrini', në raport me kompanitë e tjera ka nivel dukshëm më të ulët të kostos (0.26 €/m³), përderisa KRU 'Prishtina' ka koston dukshëm më të lartë dhe në krahasim me vitin 2017, ka arritur ta ngrisë edhe më shumë koston nga 0.43 €/m³ në 0.55 €/m³ dhe e cila ngritje mund ti atribuohet zvogëlimit të shitjeve volumetrike prej 2%, përderisa shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale janë rritur në nivelin prej 24%.

Kostot e larta në KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina" kanë ndikuar që sektori të këtë trend negativ në vitin 2018 në raport me vitin 2017, ndërsa kompanitë që kanë treguar trende pozitive në këtë tregues janë KRU "Hidromorava" dhe KRU "Bifurkacioni".

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujësjellës e realizuar në raport me atë të planifikuar

Po ashtu është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, dhe si i tillë ka ndikim në performancën e furnizimit me ujë. Ky tregues paraqet kostot për njësi të furnizimit me ujësjellës të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale zbritur për subvencionet e pranuar / shitjet volumetrike) në raport me kostot e planifikuara (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale/ shitjet volumetrike).




Fig. 14. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Përbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifar 4 (2018-2020) konkretisht për vitin 2018 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2017), gati tek të gjitha KRU ishin më të larta se sa ato të planifikuara, me përjashtim të KRU "Mitrovica" e cila pothuajse është në nivelin më të dëshiruar prej 87%. Megjithatë edhe kjo nuk tregon një performancë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukurore dhe zhvlerësimin sipas koston aktuale për asetet e reja, e që nuk ka ndodhur ti realizoj ato as 6% të tyre, duket tejkaluara mandej shpenzimet operative për 41%.

Në nivel të sektorit përbushja e objektivave të kostove për njësi e furnizimit me ujë në 2018, edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90% dhe krahasuar me vitin paraprak është përkeqësuar për 15% nga 98% në 105%.

Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2018 sipas procesit tarifar 4 (2018-2020).

Për vitin 2018, KRU kanë paraparë shpenzime të konsiderueshme rreth 17,8 milion €, për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale për shërbime të ujit, këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Në realitet, shpenzimet aktuale ishin më të larta se sa niveli i pritur duke tejkaluara ato për 17%.

Investimet e realizuara kanë vazhduar të jenë kryesisht nga grantet (donacionet zhvillimore), të cilat kapin vlerën prej 14.3 mil.€ apo 69% nga totali i investimeve, ndërsa më pak investime janë bërë nga mjetet vetanake dhe atë prej 6.4 mil.€ apo 31%.

Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara për vitin 2018




Fig. 15. Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë/shpenzimet e planifikuara (%)

Nga Plani i Biznesit vërehet se për vitin 2018 përqindja më e lartë e investimeve nga totali i investimeve, kanë qenë të planifikuara nga KRU “Hidroregjioni Jugor” dhe atë në vlerë prej 7 milion^{€3}, përderisa janë realizuar 273,327€ apo 4%. Gjithashtu edhe kompanitë e tjera kanë paraparë investime në shërbimin e furnizimit me ujësjellës, të cilat varionin nga 0.4 deri 4 mil.€. por që realizimi në shumë prej tyre ishin minore.

Siç vërehet nga Fig. 15, investimet e deklaruar nga KRU ‘Prishtina’ dhe ‘Gjakova’ ishin shumë më të larta se sa ato të planifikuara në BPRR, të cilat ishin kryesisht investime nga donatorët (grande) dhe atë prej 74%(Prishtina) dhe 61% (Gjakova), se sa që ishin të financuara nga burimet vetanake financiare.

Shumat e buxhetuara nga KRU vazhdojnë të jenë shumë më ulëta se sa investimet e planifikuara të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara. Megjithatë është inkurajuese fakti se orientimi i KRU në vitet e fundit është duke u rritur me dedikimin për mirëmbajtje kapitale. Kjo me siguri se do të rezultojë në mënyrë efektive në përmirësimin e bazës së asetëve dhe të niveleve të shërbimit.

Tab. 3. Vlera e investimeve në shërbimin e ujësjellësit

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2018

Kompania	Inv. në prodhim	Inv. në distribuim	Inv. në aktivitete biznesore	Totali
Prishtina	3,999,228	6,658,519	136,642	10,794,389
Hidroregjioni Jugor	87,228	103,987	82,112	273,327
Hidrodrini	253,030	95,741	35,883	384,654
Mitrovica	-	1,238,917	112,511	1,351,428
Gjakova	6,010,291	823,687	549,201	7,383,180
Bifurkacioni	1,694	3,795	4,202	9,691
Hidromorava	514,406	52,616	3,295	570,317
Totali	10,865,877	8,977,263	923,846	20,766,986

KRU ‘Prishtina’ ka realizuar shpenzimet kapitale më të lartat nga të gjitha kompanitë e tjera prej 10.8 mil.€, prej të cilave pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë realizuar në distribuim dhe atë në përtëritje të infrastrukturës siç është rrjeta/gypat e ujësjellësit, zëvendësimi i ujëmatësve të mëdhenj, hidrantë të zjarrit nëntokësor etj. Një pjesë tjerë e investimeve të larta janë bërë edhe në zgjerimin e jo infrastrukturës tek resurset me ndërtim të fabrikës dhe me furnizim të pajisjeve makinerike. Me këto shpenzime është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit me ujë, të përmirësohet

³Vlera e investimeve në këtë RP ndryshon nga Biznesi Plani për vitin 2018, meqenëse është e rregulluar me normë të inflacionit

shërbyeshmëria e infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të standardeve të shërbimeve, e për të cilat mund të themi se janë realizuar në nivelin pothuajse të dëshiruar.

KRU “Gjakova” në raport me kompanitë mbetet në rendin e dytë për realizim të investimeve në nivelin prej 7.3 mil.€ ku pjesën më të madhe të tyre i ka realizuar në rritje të jo infrastrukturës në resurse dhe atë kryesisht për ndërtimin e fabrikës së re për prodhim të ujit (faza e dytë), ndërsa pjesën tjetër në rritjen dhe përtëritjen e infrastrukturës dhe jo infrastrukturës në distribuim: ndërrimin e ujësjellësit, vendosjen e ujëmatëseve, furnizim me automjete dhe pajisje elektrike-mekanike etj.

Kompania e cila sipas BPRR për vitin 2018 kishte planifikuar investime më së shumti në raport me kompanitë e tjera rreth 7 mil. € dhe që ka realizuar vetëm 4% të tyre ishte KRU “Hidroregjioni Jugor”. Nga kjo kompani janë pritur të bëhen investime të konsiderueshme në projektet e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e Rajonit të Anadrinisë, Rajonit të Hasit, fshatrave të komunës së Malishevës, Suharekës e shumë fshatra të tjera që janë nën menaxhimin e KRU, pastaj projekte tjera si furnizim me pompa, rehabilitimi i rrjetit dhe ndërrimi i gypave etj.

Ndikimin kryesor për mos përmbushjen e investimeve të planifikuara në lartësinë e aprovuar në shumicë, mund ti atribuohet mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit, si dhe rritjes së shpenzimeve operative dhe mos pranimit të donacioneve të planifikuara në Biznes Planet e tyre për vitin 2018.,duke rezultuar me mungesën e mjeteve aq të nevojshme për investime kapitale.

3.2. SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

Ky kapitull ofron analizë të performancës teknike, financiare dhe shërbimeve të konsumatorve të ofruar nga KRU në shërbimin e ujërave të ndotura. Analiza mbulon: (i) standardet e shërbimit (cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara) (ii) aspektin operativ (frekuenca e bllokimit të kanalizimeve, (iii) komerciale (mbulueshmëria me shërbime, ankesat), (iv) financiare (vlerat e shitjeve, kostot njësi, shpenzimet kapitale).

3.2.1 Performanca jo-financiare (teknike)

Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Testimi i ujërave të ndotura nga KRU është mjaft e kufizuar, ashtu siç është edhe në përgjithësi edhe trajtimi i ujërave të ndotura në Kosovë. Krahas impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Skënderaj me kapacitet vjetor rreth 734,421 m³, i menaxhuar nga KRU ‘Mitrovica’, ekzistojnë edhe 2 Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (Harilaq dhe Badovc) me kapacitet të vogël (104,750 m³/vit) dhe të menaxhuar nga KRU ‘Prishtina’.

Këto dy KRU kanë bërë edhe disa teste të shkarkimeve të ujërave të ndotura kryesisht në laboratorët e veta.

KRU ‘Mitrovica’, nga 48 testet e bëra dhe të gjitha i ka raportuar se kanë qenë në përputhje me vlerat e lejuara, përderisa edhe KRU ‘Prishtina’, ka bërë teste në laboratorinë e saj dhe nga 24 teste e bëra, ato të gjitha, kanë rezultuar të jenë në përputhje me vlerat e lejuara. Aspektet ligjore dhe vlerat parametrike të lejuara për trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 30/2014, i cili është në mbikëqyrjen institucionale nga MMPH.

Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Tregon numrin e incidenteve të raportuara në lidhje me bllokimet e kanalizimeve të raportuara nga KRU (ose të identifikuara nga personeli i KRU) në periudhën raportuese për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit.




Fig.16 Numri i bllokimeve për 100 km

Gjatë vitit 2018 numri i bllokimeve në rrjetin e kanalizimit për 100 km gjatësi në nivel sektori është raportuar të jetë në nivel më të lartë krahasuar me vitin 2017 për 35%.

Të gjitha kompanitë kanë raportuar të dhëna sa i përket treguesit për bllokimet e kanalizimit, në përjashtim të KRU ‘Hidrodrini’ dhe ‘Hidromorava’ të dy këto kompani që nuk kanë mundur të evidentohen të dhëna sa i përket këtij treguesi. Kompania e cila ka raportuar më së shumti të dhëna sa i përket bllokimeve me kanalizim gjatë vitit 2018 është KRU ‘Gjakova’ me 1,030 bllokime për 100 km gjatësi të rrjetit, ndërsa sa i përket vitit paraprak 2017 nuk ka ofruar informacione. Në të njëjtën pozitë sa i përket raportimit qëndron edhe KRU ‘Mitrovica’ e cila gjatë vitit 2017 nuk ka ofruar informata për këtë tregues ndërsa në vitin 2018 numri i bllokimeve të kanalizimit kap vlerën prej 436 bllokime për 100 km. Kompania e cila është ranguar me numrin më të vogël të bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit është KRU ‘Bifurkacioni’ me 60 bllokime për 100 km e cila në raport me vitin paraprak 2017 ka shënuar rënie prej 80%.

Kompanitë të cilat nuk kanë prezantuar të dhëna sa i përket bllokimeve, nuk është për shkakun se nuk kanë pasur probleme sa i përket bllokimeve me kanalizim por për arsye se kompanitë nuk kanë mbajtur evidencë të rregullt. Performanca e këtij treguesi varet direkt nga vjetërsia e rrjetit ekzistues të kanalizimit, mirëmbajtja, si dhe pastrimi i rregullt i tij. Ky tregues bënë matjen e performancës së gjëndjes së rrjetit ekzistues të kanalizimit me qëllim të orientimit të investimeve në drejtim të ripërtëritjeve infrastrukurore. Si duket shumica e infrastrukturës së rrjetit të kanalizimit kanë nevojë për rehabilitim dhe zgjerim. Ofruesi i shërbimeve duhet po ashtu të zhvillojë dhe implementojë një program të detajuar për të inspektuar dhe pastruar gypat e rrjetit të kanalizimit.

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi)

Për të njëjtat arsye të cekura tek treguesi “Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit”, edhe ky tregues është analizuar/kalkuluar nga tri këndvështrime/versione.

Në pjesën e parë (fig.17) - Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura (kanalizim).





Fig.17. Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura (%)


Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura në nivel sektori gjatë vitit 2018, arrin nivelin prej 77%, dhe është për 3% më e lartë se viti paraprak 2017.

Vlen të theksohet se sikurse tek mbulueshmëria me shërbime të ujësjetës, janë të njëjta shkaqe të cilat duket se kanë rritur normat e mbulimit me këtë shërbim.

Bazuar në të dhënat e dala nga aktiviteti i Projektit mbështetës, në terma të vend-banimeve të këtyre komunave, janë 384 vend-banime nga gjithsej 1,228 të cilat kanë qasje në sistemet publike të grumbullimit të ujërave të ndotura.



Në terma të numrit të banorëve, shtatë Ofruesit e shërbimeve sigurojnë shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura tek 64% e popullatës, në gjithsej 28 komunat përkatëse. Trajtimi i ujërave të ndotura në nivel të sektorit përfshinë 0.7% nga tërë sasia e ujërave të ndotura të faturuara konsumatorëve nga shtatë Ofruesit e shërbimeve.



Sikurse tek Mbulueshmëria me Shërbime të Ujësjetës, për analizimin real të përqindjes së mbulueshmërisë të popullatës me Shërbime të ujërave të ndotura, faktor kyç i kalkulimit është numri i banorëve dhe ekonomive familjare (të dhëna këto të cilat aktualisht janë të kalkuluara në bazë të regjistrimit të vitit 2011). Me qëllim të paraqitjes së saktë të këtij treguesi shpresojmë që në afat sa më të shkurtë kohor të kemi informatat e sakta të cilat do të jenë të bazuara në regjistrimin e popullatës nga ASK. Ndërkohë ARRU në bashkëpunim me të gjitha palët do të vendosë për versionin më të arsyeshëm të matjes së performancës së këtij treguesi për vitet në vijim.

Ankesat

Ky tregues paraqet numrin total të ankesave të pranura nga KRU në lidhje me nivelet e shërbimit (vërshimeve të kanalizimeve etj.), si dhe aspektet financiare-komerciale në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese.




Fig.18, numri i ankesave për shërbimin e ujërave të ndotura

Ankesat teknike për shërbimin e ujërave të ndotura kryesisht kanë të bëjnë me bllokimet e kanalizimeve, përfshirë rastet e përmbytjeve dhe pastrimit të kanalizimeve, përderisa ankesat e natyrës komerciale më tepër janë për shkakun e kontestimit të saktësisë së faturimit dhe mënyrës së faturimit. Konsumatorët janë ankuar më pak për çështjet komerciale në shërbimin e ujërave të ndotura.

Gjatë vitit 2018 numri total i ankesave për shërbimet e ujërave të ndotura arrin vlerën 4,651, prej të cilave 4,638 kanë të bëjnë me aspektet teknike ndërsa 13 me ato komerciale.

Numri i ankesave të paraqitura nga ana e konsumatorëve si teknike edhe atyre komerciale për shërbimet e ujërave të ndotura gjatë vitit 2018 kanë shënuar rritje për 1,456 krahasuar me vitin paraprak 2017, apo shprehur në përqindje për 46%.

Ndikim tek kjo rritje gjatë vitit 2018 në raport me vitin 2017 ka pas numri i madh i ankesave për shërbimin e ujërave të ndotura nga KRU 'Prishtina'. Kompania e cila nuk ka raportuar fare ankesa teknike në shërbimet e ujërave të ndotura është KRU 'Bifurkacioni'.

3.2.2. Performanca financiare

Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (EUR)

Në këtë pjesë është dhënë një vlerësim mbi performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifar 2015-2017 (viti 2017) dhe për procesin tarifar 2018-2020 (viti 2018).




Fig.19, vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me planifikimet (Euro)

Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, vlera e shitjeve aktuale në shërbimet e ujërave të ndotura në nivel të sektorit gjithashtu është nën vlerat e planifikuara pasi që është drejtpërdrejtë e lidhur me volumet e shitjeve të ujit.

Shumica e kompanive nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit 2018, madje në disa prej tyre janë më të ulëta se sa ishin në vitin 2017, në përjashtim të KRU “Mitrovica”, “Hidrodrini” dhe “Hidromorava”, të cilat madje i kanë tejkaluar objektivat e planifikuara për 12% (Mitrovica), 4% (Hidrodrini), dhe 2% (Hidromorava).

Kompania e cila ka arritur ta ketë performancën më të dobët në realizimin e shitjeve të ujërave të ndotura është KRU “Hidroregjioni Jugor” me 86%, njëkohësisht me një rënie prej 1% krahasuar me vitin paraprak 2017.

Në nivel të sektorit në vitin 2018 vlera e shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura ishte 4,119,947€, ndërsa ajo e planifikuar 4,315,941€, kjo do të thotë së 95% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar dhe është më e lartë për 2% krahasuar me vitin 2017 kur ajo ishte 93%

Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura




Fig. 20, Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2018 në raport me vitin 2017

Figura më lart tregon trendët e vlerës së shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese 2018 në raport me vitin 2017. Për dallim nga shërbimet e ujit ku kishte më shumë kompani që kanë treguar trende pozitive tek ujërat e ndotura. Vetëm tri nga shtatë KRU kanë shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin 2017.

KRU “Hidroregjioni Jugor” është kompania që ka realizuar shitjet më të larta në vitin 2018 me 26.13% në raport me vitin 2017, përderisa kjo kompani tek shërbimet e ujit kishte treguar trende negative, rezultat i kësaj ngritje ka qenë ngritja e numrit të konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura për 8%, duke ndikuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike për ujëra të ndotura. Në vlerë absolute shitjet në nivel sektori në 2018 janë për 5.26 % më të larta se sa në vitin 2017.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura⁴

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore për konsumatorët shtëpiak të shërbyer⁵.




Fig. 21. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në nivel të sektorit në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ka qenë më e lartë për 1.46 €/kons. ose 25%.

Si vërehet edhe nga figura më lart në katër nga shtatë kompanitë për vitin 2018 kemi pas rënies të koston për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura, rezultat i të cilave rënies ka qenë ngritja e numrit të konsumatorëve shtëpiak të shërbyer, përkundër rritjeve të shpenzimeve totale për ujëra të ndotura në shumë nga këto kompani.

Koston më të ulët në këtë tregues për vitin 2018 e ka KRU ‘Hidrodrini’, me 4.83 €/kons. më një rënie prej 2.89 €/kons. krahasuar me vitin paraprak, përderisa kosto më e lartë për vitin 2018 në raport me vitin 2017 ka KRU “Hidroregjioni Jugor”, me një rritje gjithashtu nga viti paraprak prej 0.72 €/kons. ose 7%, rezultat i të cilës kanë qenë shpenzimet e larta operative, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Njëkohësisht nga figura vërejmë së KRU ‘Hidrodrini’ është kompania e cila ka arritur të këtë përmirësimin më të lartë të koston për njësi të ujërave të ndotura në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 dhe atë prej 37%, ku rezultat i këtij ndryshimi (zvogëlim i koston) ka qenë kryesisht zvogëlimi i shpenzimeve operative për shërbimin e ujërave të ndotura në nivelin 34%.

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar në raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura është një tregues po ashtu i rëndësishëm financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilit matet performanca e ujërave të ndotura. Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke

⁴ Kostoja për njësi e vitit 2017 është e rregulluar për normën të inflacionit 1.02 dhe ndryshon nga kostoja e paraqitur në Raportin paraprak të performancës

⁵ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definojnë si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak⁶) dhe kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak).




Fig. 22. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(%)

Përbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifar 4 (2018-2020) konkretisht për vitin 2018 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2017), gati në të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara.

Edhe pse KRU “Hidroregjioni Jugor” në krahasim me kompanitë e tjera ka arritur përqindjet më të larta të realizimit nga caku i planifikuar, prapë nuk ka treguar performancë të mirë, për arsye se ka tejkaluar shpenzimet operative për 16%, përderisa shpenzimet për mirëmbajtje kapitale nuk ka arritur as 4% të tyre ti realizoj.

Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit.




Fig. 23. shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planifikimet(%)

Sikurse të shërbimet me furnizim me ujë, kompanitë për vitin 2018 kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 18.8 milion € për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura, të parapara të sigurohen si

⁶ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definojnë si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta së niveli i pritur, dhe atë prej 2 milionë€ ose 11% nga ajo që ishte planifikuar gjatë procesit tarifor 2018-2020 (konkretisht viti 2018).

Për vitin 2018 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzohen rreth 0.8 mil.€ të cilat shpenzime edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, por që shumica e kompanive nuk kanë arritur që ato shpenzime ti realizojnë as 8% prej tyre, me përjashtim të KRU “Prishtina”.

Sa i përket investimeve të realizuara në shërbimet e ujërave të ndotura prinë KRU ‘Prishtina’ me 713%, të shumës totale të investimeve (1,890,931€), të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në përtëritje të infrastrukturës në grumbullimin e ujërave të ndotura. Shumica e KRU nuk kanë arritur as 1% të vlerës totale të investimeve të investojnë në shërbimin e ujërave të ndotura .

Brengosëse është situata me KRU “Hidroregjioni Jugor” dhe KRU “Gjakova” të cila kanë planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura, prej të cilave kanë realizuar vetëm 0.1% (Hidroregjini Jugor) përkatësisht 8% (Gjakova).

Tabela 4, Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të ndotura

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2018						
KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali	
Prishtina	1,886,612	0	0	4,319	1,890,931	
Hidroregjioni Jugor	0	0	0	10,777	10,777	
Hidrodrini	8,976	0	0	1,859	10,835	
Mitrovica	0	0	0	12,501	12,501	
Gjakova	15,274	0	0	29,669	44,942	
Bifurkacioni	0	0	0	3,786	3,786	
Hidromorava	0	0	0	248	248	
Totali	1,910,862	0	0	63,159	1,974,020	

Sikurse tek investimet për ujësjellës ashtu edhe te ujërat e ndotura prin KRU ‘Prishtina’ me realizimin e investimeve prej 96% të shumës totale të investimeve (1,974,020 Euro) dhe e cila përqindje është realizuar kryesisht në përtëritje të infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të ndotura.

KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, KRU ‘Gjakova’ dhe KRU ‘Hidromorava’ janë kompanitë që kanë planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura: në rritje dhe rehabilitim të rrjetit, në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, ndërtimin e kolektorëve kryesor për grumbullimin e ujërave të ndotura etj, e që realisht këto kompani nuk kanë arritur as 1% prej tyre ti realizojnë.

Është dëshpëruese se edhe përkundër kërkesave të mëdha për investime kapitale të cilat i ka ky shërbim, shumat e buxhetuara si nga KRU ashtu edhe nga Agjencionet zhvillimore në vend, vazhdojnë të jenë shumë minore në raport me kërkesat.

3.3. PERFORMANCA FINANCIARE E KRU

Kjo pjesë e raportit pasqyron qëndrueshmërinë financiare të KRU përmes dy treguesve të rëndësishëm financiar, shkalla e arkëtimit, si dhe kthimi në kapital.

Arkëtimi i të ardhurave

Në vijim është paraqitur performanca e kompanive në treguesin shkalla e arkëtimit për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, i paraqitur si raport në mes të arkëtimit të keshit ndaj faturimit të rregullt për shërbimet e ofruara të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, duke përfshirë taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera operative. Ky është njëri prej treguesve më domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Fig. 24. Efiçienca në arkëtimin e të ardhurave/ faturimit (përfshirë të ardhurat e tjera operative)

Siç vërehet edhe nga figura 24 në vitin 2018, gati tek të gjitha kompanitë kemi një përmirësim më të theksuar të efijencës së arkëtimit të borxheve për shërbimet e furnizimit me ujësjellës dhe të ujërave të ndotura, përfshirë KRU 'Bifurkacioni' e cila ka treguar performancë më të dobët krahasuar me vitin 2017.

Progresin më të lartë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Mitrovica' me një ngritje prej 16% krahasuar me vitin paraprak, rezultat i së cilës kryesisht ka qenë ndërmarrja e disa aktiviteteve nga kompania siç janë: aplikimi i shkyçjeve individuale, puna e vazhdueshme me përmbarues dhe aktivizimi i inkasantëve mobil.

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura si mesatare e sektorit për vitin 2018 ishte 91% dhe është për 8% më e lartë se sa në vitin 2017.

Objektiva e përcaktuar me proceset rregullatore (tarifore) për vitin 2018 në nivel të sektorit ka qenë 88%, përderisa ky cak aktualisht në nivel të sektorit ka arritur të tejkalohet për 3%.

Kompanitë të cilat kanë arrit planifikimet e tyre madje duke i tejkaluar ato ishin KRU "Gjakova" me 9%, KRU "Hidroregjioni Jugor" 7%, KRU "Prishtina" 5% dhe KRU "Hidrodrini" me 1%, përderisa nën nivelin e planifikimit prej (-4%) mbetet KRU "Mitrovica" edhe pse krahasuar me vitin paraprak kishte një përmirësim dukshëm më të lartë, pastaj KRU "Bifurkacioni" me (-5%) dhe KRU "Hidromorava" me (-4%).

Efiçienca e ulët e arkëtimit në shumicën e kompanive i përket në përgjithësi mos pagesave të faturave nga konsumatorët e amvisërisë, por edhe nga një pjesë e konsumatorëve komercial dhe atyre institucional nga të cilat kompanitë nuk mund të mbledhin keshin e faturuar.

Tab.5, Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2017-2018

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Amvisëri	85%	94%	98%	96%	78%	83%	48%	60%	88%	92%	81%	81%	76%	79%
kom.-industrial	90%	97%	69%	89%	88%	84%	69%	83%	83%	111%	95%	105%	93%	89%
Institucione	98%	112%	108%	105%	80%	107%	97%	122%	83%	107%	57%	45%	89%	125%
Sektori	88%	97%	95%	96%	80%	87%	56%	72%	87%	97%	81%	80%	79%	84%

Nga tabela më lart vërejmë së përmirësimi i normës së arkëtimit pa përjashtim në tre kategoritë e konsumatorëve në shumicën e kompanive mbetet ende sfidë për tu përmirësuar.

Këtë vit KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ mban rekordin me 96% të arkëtimit në amvisëri, përderisa KRU “Gjakova” kryeson me normën më të lartë të arkëtimit në kategorinë e bizneseve me 111% dhe KRU “Hidromorava” me përqindjen më të lartë të arkëtimit nga konsumatorët institucional me 125%.

Në KRU ‘Mitrovica’ konsumatorët e amvisërisë mbesin paguesit më të dobët të borxheve. Vetëm 60% të tyre arrijnë ti shlyejnë borxhin për shërbimin e ofruar nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Megjithatë është e rëndësishme të cekim se përmirësimi i efijencës së arkëtimit kërkon angazhim permanent dhe të vazhdueshëm përmes zhvillimit të planeve të qëndrueshme të veprimit, përmirësimin e leximit të rregullt të ujëmatësve, faturim të rregullt, si dhe ndërmarrjen e masave operative dhe ligjore me kohë për konsumatorët e pandërgjegjshëm.

Kthimi në kapital

Kostoja e kapitalit është një zë i rëndësishëm i çmimit - tarifës për një industri me kapital intensiv, siç është industria e shërbimeve të ujit në shumë vende të botës, kjo ndodh edhe tek ne. Baza rregullatore e aseteve (BRRA) në vendin tonë për sektorin e shërbimeve të ujit është caktuar në vitin 2009, që nga procesit i parë tarifor trevjeçar (2009-2011), ku ARRU përcaktoi kthimet e lejuara bazuar në vlerësimin e saj të koston së kapitalit për KRU. Me kufizimet e çmimeve dhe të ardhurave, rregullatori ka vlerësuar koston efikase të ofrimit të shërbimit edhe për periudhën e ardhshme tarifore (2018-2020) dhe lejojë që kompania e rregulluar të mbulojë atë kosto nëpërmjet pagesave të konsumatorëve me kushtin e plotësimit të efikasitetit. Për procesin tarifor (2018-2020), norma e kthimit në kapital është 4%.




Fig. 25, Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka treguar trend negativ krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 4.97% nga 5.31% sa ishte në vitin 2017 në 0.34% për vitin 2018 .

Pesë nga shtatë KRU (Hidrodrini, Hidromorava, Hidroregjioni Jugor, Gjakova dhe Bifurkacioni) në vitin 2018 vazhdojnë të kenë kthime pozitive, edhe pse në raport me vitin 2017 shumica prej tyre kanë treguar trende negative, në përjashtim të KRU 'Hidrodrini' e cila madje e ka tejkaluar nivelin e planifikuar prej 0.4%, e që do të thotë se ka arritur ti mbajë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRRRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

Për dallim nga viti i kaluar KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Mitrovica, kishin përkeqësimin më të madh të normës së kthimit në kapital, nga 5.92% në -0.15% (Prishtina) dhe nga 3.4% në -10.46% (Mitrovica), rezultate si këto të ndodhura për shkak të shpenzimeve të larta operative duke përfshirë përtëritjen infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale, njëkohësisht edhe zvogëlimin të të hyrave duke përfshirë edhe subvencionin siç është rasti te KRU 'Mitrovica' ku për 42% është më i ulët se sa në vitin 2017.

3.4 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU

Performanca e KRU është vlerësuar në bazë të nivelit të përmbushjes së objektivave të Treguesve Kyç të Performancës (TKP), në mënyrë specifike për të dyja shërbimet (Furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të ndotura), si dhe është vlerësuar performanca e përgjithshme e kombinuar me performancën e të dy shërbimeve me atë të përgjithshme financiare. Programi i monitorimit i udhëhequr nga ARRU pasqyron nivelet e shërbimit dhe efikasitetin e kostos, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi konsumatorët. Performanca matet në mënyrë absolute ndaj nivelit të Performancës së supozuar-'ideale'. ARRU ka përzgjedhur një skemë me TKP dhe ka peshuar rendësinë e tyre (një peshë më e lartë pasqyron sa kritike është treguesi për cilësinë e shërbimit apo edhe qëndrueshmërinë financiare). KRU, janë renditur në arritjet e performancës së tyre, sipas treguesve dhe objektivave përkatëse të paraqitura në Tabelën faqe 68 (skema e TKP).

3.4.1. PERFORMANCA E FURNIZIMIT ME UJËSJELLËS

Kjo pjesë e raportit vlerëson performancën e KRU për disa nga treguesit kyç të lidhur me nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit, si dhe efikasitetin komercial në shërbimin e furnizimit me ujë. Niveli i përgjithshëm i furnizimit me ujësjellës vazhdon të performojë më mirë në 2018, në raport me vitin 2017. Furnizimi me ujë (i matur në raport me objektivat) ishte 0.8% pikë mbi rezultatin e arritur në 2017. KRU kanë përmirësuar disa nga standardet e rëndësishme të shërbimit, si dhe kanë ngritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujësjellës




Fig.26, Paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së furnizimit me ujësjellës si dhe rangimi i KRU-2018

Tabela 6, Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujësjellës në vitin 2017

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efiç.e kostove	Totali për KRU
Ideal	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	20.0%	10.0%	45%
GJA	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	8.3%	6.7%	38.2%
PE	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	0.0%	8.7%	35.4%
PR	24.9%	5.0%	15.5%	20.0%	1.5%	10.0%	34.6%
MIT	25.0%	5.0%	19.3%	15.2%	0.0%	10.0%	33.6%
GJI	24.9%	5.0%	20.0%	15.0%	2.3%	6.2%	33.0%
FE	24.6%	5.0%	18.4%	18.5%	2.7%	2.5%	32.3%
PZ	25.0%	5.0%	19.9%	14.1%	1.2%	6.1%	32.1%
Sektori	24.9%	5.0%	19.2%	17.5%	2.2%	7.2%	34.2%

Tabela 7, Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujësjellës në vitin 2018

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efiç.e kostove	Totali për KRU	Ndryshimi 2018/2017
Ideal	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	20.0%	10.0%	45%	
GJA	24.9%	5.0%	20.0%	20.0%	9.4%	4.6%	37.8%	-0.4%
PE	24.8%	5.0%	20.0%	20.0%	0.0%	9.2%	35.5%	0.1%
GJI	24.7%	5.0%	20.0%	15.6%	4.2%	8.8%	35.2%	2.2%
MIT	24.9%	5.0%	20.0%	16.2%	0.4%	10.0%	34.5%	0.9%
PR	24.9%	5.0%	19.7%	20.0%	0.0%	5.4%	33.8%	-0.9%
FE	24.3%	5.0%	18.5%	19.4%	0.0%	7.0%	33.4%	1.2%
PZ	24.9%	5.0%	20.0%	14.5%	1.8%	7.7%	33.2%	1.1%
Sektori	24.8%	5.0%	19.7%	18.0%	2.3%	7.5%	34.8%	
Ndryshimi 2018/2017	-0.1%	0.0%	0.7%	0.4%	0.0%	0.4%	0.6%	0.6%

Fig. 26, dhe tab. 7, krahason ecurinë e performancës së KRU, në raport me objektivat e PMV. Arritjet e dukshme specifike gjatë vitit 2018/2017, janë komentuar në vijim:

Ka pasur pak përmirësime në 3 nga 6 TKP, të shërbimit të furnizimit me ujësjellës. Performanca u zvogëlua pak në treguesin e cilësisë së ujit, përderisa në treguesin e presionit performanca e KRU është e plotë, pa përjashtim.

Performanca mesatare e furnizimit me ujë ka arritur nivelin 34.8% nga maksimumi prej 45%, të ndarë për këtë shërbim, progresi është për 0.6%, në vitin 2018/2017.

Janë pesë KRU, të cilat kanë përmirësuar performancën e tyre në vitin 2018/2017. Në KRU 'Hidromorava' është treguar përmirësim më i lartë (2.2%), vazhduar me Bifurkacionin (1.2%), Hidroregjioni jugor (1.1), Mitrovica me 0.9% dhe vetëm 0.1% është përmirësuar KRU 'Hidrodrini'.

Cilësia e ujit ishte për 0.1% më e ulët se në 2017. Me 24.8% të pikëve të arritura nga idealja prej 25%, është një cilësi e mirë e ujit të pijshëm i ofruar nga KRU. Në të gjitha KRU, përjashtuar KRU 'Prishtina', cilësia e ujit ka rënë pak në raport me vitin paraprak.

Presioni i ujit në rrjetë, është një masë kyçe e nivelit të performancës së shërbimit edhe pse në skemën TKP i është dhënë një peshë simbolike, për faktin se në asnjë nga KRU nuk i është dhënë një rëndësi për monitorimin dhe matjen e presionit të rrjetit. Me përjashtim të një numri të vogël pronash të raportuar nga disa KRU, të kenë probleme në sigurimin e presionit referues, ky tregues është i përmbushur në përgjithësi nga të gjithë Kompanitë e tjera.

Vazhdimësia e furnizimit me ujë është përmirësuar për 0.7%. Viteve të fundit janë realizuar një numër projektesh të mëdha për ngritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit, me synim për të përmirësuar vazhdimësinë e furnizimit me ujë, veçanërisht kjo ka ndodhur në KRU ‘Prishtina’, ‘Mitrovica’ dhe ‘Gjakova’. Sektori ka arritur në 19.7% të pikëve nga max. prej 20% për këtë tregues. Pritje për përmirësimin e vazhdimësisë së furnizimit aktualisht janë në: KRU ‘Bifurkacioni’, ‘Hidroregjioni Jugor’, ‘Prishtina’ dhe KRU ‘Hidromorava’.

Mbulueshmëria me shërbime ka shënuar progres në shtatë KRU dhe mesataren e sektorit gjatë vitit 2018, në raport me vitin 2017. Është e evidente një rritje e vazhdueshme e konsumatorëve të rinj, në të gjitha zonat e furnizimit të koncentruar në zona urbane. KRU ‘Prishtina’, ‘Gjakova’ dhe ‘Hidrodrini’, kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime. Performanca e përgjithshme ka arritur nivelin 18% nga totali prej 20% dhe është 0.4% më e përmirësuar se një vit më parë (2017), përderisa shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit gjatë vitit 2018 e ka shënuar KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, ndonëse edhe kjo ka shënuar progres .

Uji i pa faturuar nuk ka shënuar ndonjë përmirësim. Performancën më të mirë në këtë tregues vazhdon ta ketë KRU ‘Gjakova’, po ashtu në pesë nga shtatë KRU (Hidrodrini, Mitrovica, Hidromorava Hidroregjioni Jugor dhe Gjakova), kanë treguar përmirësim në performancën e tyre gjatë vitit 2018, përderisa tek KRU ‘Prishtina’ dhe ‘Bifurkacioni’ është rritur UPF. Në përgjithësi KRU aktualisht kanë performancë të dobët në UPF ku vetëm 2.3% janë pikët e tubuara nga 20% i mundshëm.

Efiçienca e kostove në nivel të sektorit, në shërbimin e furnizimit me ujësjellës, në raport me kostot e planifikuara, po ashtu është përmirësuar për 0.4%. Nivel i lartë i efiçencës së kostove është arritur në KRU ‘Mitrovica’, përderisa në KRU ‘Gjakova’ efiçienca e kostove është më e ulët dhe atë me vetëm 4.6% nga totali prej 10%, rezultat i së cilës ishte tejkalimi shumë i lartë i shpenzimeve operative në raport me planin në nivelin prej 20%.

3.4.2 PERFORMANCA E SHËRBIMEVE PËR UJËRA TË NDOTURA

Në këtë pjesë në vijim pasqyrohet vlerësimi i performancës së KRU në disa nga treguesit kyç për këtë shërbim, të cilët njëkohësisht janë të rëndësishëm për konsumatorin dhe mjedisin.




Fig. 27, Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të ndotura -2018/2017

Tab. 8. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2017

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efiç. e kost.	Totali
Ideal	20%	20%	50%	10%	35%
PR	0.0%	0.0%	50.0%	4.2%	19.0%
FE	0.0%	0.0%	40.4%	6.4%	16.4%
GJA	0.0%	0.0%	36.0%	8.7%	15.6%
GJI	0.0%	0.0%	32.6%	5.8%	13.5%
MIT	0.0%	0.0%	29.3%	3.7%	11.5%
PZ	0.0%	0.0%	30.9%	1.9%	11.5%
PE	0.0%	0.0%	21.9%	4.2%	9.1%
Sektor	0.0%	0.0%	34.5%	5.0%	13.8%

Tabela 9. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2018

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efiç. e kost.	Totali	Ndryshimi 2018/2017
Ideal	20%	20%	50%	10%	35%	
PR	0.0%	0.0%	50.0%	4.8%	19.2%	0.2%
FE	0.0%	0.0%	43.2%	4.8%	16.8%	0.4%
GJA	0.0%	0.0%	36.8%	7.3%	15.5%	-0.2%
GJI	0.0%	0.0%	34.5%	5.9%	14.1%	0.7%
MIT	0.0%	0.0%	31.5%	3.8%	12.4%	0.8%
PZ	0.0%	0.0%	32.6%	1.9%	12.1%	0.6%
PE	0.0%	0.0%	24.1%	6.4%	10.7%	1.6%
Sektor	0.0%	0.0%	36.1%	5.0%	14.4%	
Ndryshimi 2018/2017	0%	0%	1.6%	0.0%	0.6%	0.6%

Edhe këtë vit ne nuk kemi vlerësuar performancën e plotë të shërbimeve të ujërave të ndotura, për shkakun se dy treguesit, ai i cilësisë së shkarkimeve i lidhur me mungesën e trajtimit të ujërave të ndotura si dhe treguesi i besueshmërisë së shërbimit të ujërave të ndotura, për shkak të të dhënave jo të besueshme nga të gjitha KRU, nuk kanë ndonjë relevancë objektive. Prandaj analiza në këtë shërbim është përqëndruar vetëm në treguesit: mbulueshmëria me shërbime, si dhe efiçencën e kostove.

Performanca e shërbimeve të ujërave të ndotura ka vazhduar të përmirësohet me ritëm gradual edhe këtë vit, përmirësimi është vetëm 0.6% në raport me vitin 2017. Janë 6 KRU përjashtuar KRU 'Gjakova', të cilat kanë shënuar trende të lehta pozitive në këtë shërbim. Aktualisht arritja në këtë shërbim është në nivelin 14.4% e performancës ideale për këtë shërbim (35%). Kjo është dukshëm nën nivelin e furnizimit me ujë, për shkak se: trajtimi i ujërave të ndotura është shumë i ulët, mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit, po ashtu ende është në nivel jo të kënaqshëm, shpenzimet operative janë jo efiçente, si dhe vlera aktuale të investimeve kapitale është shumë e ulët.

Mbulueshmëria me sistemin e kanalizimit për ujëra të ndotura ka vazhduar të rritet, pa përjashtim nga të gjitha KRU, niveli i përgjithshëm ka arritur normën 36.1% nga idealja prej 50%, ndarë për këtë tregues, përmirësim është për 1.6% në raport me vitin paraprak(2017).

Efiçencia e kostove në shërbimin e ujërave të ndotura në nivel të sektorit gjendet në nivelin e 5% nga 10% e mundshme. Performancë më të mirë në këtë tregues ka shënuar KRU 'Gjakova' edhe pse krahasuar me vitin paraprak ka pasur rënie

prej 1.4%, përdërisa një nivel shumë të ulët të efijencës së kostove sikurse në vitin e kaluar ka treguar KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, si rezultat i tejkalimit të shpenzimeve operative për 16%, përdërisa shpenzimet për mirëmbajtje kapitale nuk ka arritur as 4% të tyre ti realizoj. Performancën më të mirë, në shërbimin e ujërave të ndotura vazhdon ta këtë KRU ‘Prishtina’(19.2%) me një trend në rritje të lehtë edhe për vitin 2018/2017. Ndërsa performancë ende e ulët në këto shërbime vazhdon të tregohet nga KRU ‘Hidrodrini’, ndonëse në vitin 2018 ka shënuar një rritje më të ndjeshme (1.6%) nga të gjitha KRU e tjera

3.4.3 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME

Performanca e Përgjithshme e KRU




Fig. 28, Performanca e Përgjithshme dhe rangimi i KRU në vitin 2018/2017

Tab. 10, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2017

KRU	Furnizim me ujësjellës	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Raportimi rregullator	Total i Pikëve
Ideal	45.0%	35.0%	5.0%	10.0%	5.0%	100.0%
GJA	38.2%	15.6%	5.0%	6.8%	4.9%	70%
PR	34.6%	19.0%	5.0%	7.0%	4.8%	70%
PZ	32.1%	11.5%	5.0%	8.7%	4.6%	62%
GJI	33.0%	13.5%	5.0%	4.9%	4.9%	61%
FE	32.3%	16.4%	1.5%	5.2%	4.6%	60%
PE	35.4%	9.1%	4.0%	5.0%	4.3%	58%
MIT	33.6%	11.5%	4.3%	0.0%	4.2%	54%
Total	34.2%	13.8%	4.6%	5.4%	4.6%	62%

Tab. 11. Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2018

KRU	Furnizim me ujësjellës	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Raportimi rregullator	Total i Pikëve	Ndryshimi 2018/2017
Ideal	45.0%	35.0%	5.0%	10.0%	5.0%	100.0%	
GJA	37.8%	15.5%	1.1%	9.2%	4.9%	68.3%	-2.1%
PR	35.5%	19.2%	0.0%	9.3%	4.8%	67.0%	-3.5%
GJI	35.2%	14.1%	4.9%	5.9%	4.8%	65.0%	3.7%
FE	34.5%	16.8%	4.0%	5.0%	4.6%	63.9%	4.0%
PZ	33.8%	12.1%	4.6%	8.9%	4.5%	63.3%	1.5%
PE	33.4%	10.7%	5.0%	6.7%	4.5%	62.4%	4.6%
MIT	33.2%	12.4%	0.0%	3.0%	4.4%	54.2%	0.7%
Total	34.77%	14.38%	2.80%	6.85%	4.62%	63.43%	
Ndryshimi 2018/2017	0.6%	0.6%	-1.4%	1.5%	0.04%	1.29%	1.29%

Furnizimi me ujësjellës ka pasur një përmirësim të lehtë në 3 TKP (Vazhdimësia e furnizimit, Mbulueshmëria dhe Eficienca e kostove) nga 6 sosh, sa janë të shërbimi i furnizimit me ujësjellës. Performanca u zvogëluar pak në treguesin e cilësisë së ujit, përderisa në treguesin e presionit performanca e KRU mbetet e plotë, pa përjashtim.

Performanca mesatare e furnizimit me ujë ka arritur nivelin 34.77% nga maksimumi prej 45%, të ndarë për këtë shërbim. Progresi është për 0.6% në vitin 2018/2017.

Shërbimi i Ujërave të ndotura ka vazhduar të përmirësohet me ritëm gradual edhe këtë vit, përmirësimi është vetëm 0.6% në raport me vitin 2017. Janë 6 KRU përjashtuar KRU 'Gjakova', të cilat kanë shënuar trende të lehta pozitive në këtë shërbim. Aktualisht arritja në këtë shërbim është në nivelin 14.38% e performancës ideale për këtë shërbim (35%). Kjo është dukshëm nën nivelin e furnizimit me ujë, për shkakun se: trajtimi i ujërave të ndotura është shumë i ulët, mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit, po ashtu ende është në nivel jo të kënaqshëm, shpenzimet operative janë jo eficiente si dhe vlera aktuale e investimeve kapitale është shumë e ulët.

Profitabiliteti paraqet kthimin aktual në bazën rregullatore të aseteve në raport me kthimin në kapital të projektuar. Për procesin tarifor (2018-2020) norma e kthimit në kapital ka qenë 4%. Shkalla e profitabilitetit në mesatare të sektorit për 2018, ishte realizuar në nivelin prej 0.3%, kjo ishte dukshëm më e përkeqësuar së një vit më parë (2017). Me përjashtim të KRU "Hidrodrini" të gjitha kompanitë e tjera kanë pasur trende negative në raport me vitin 2017. Janë 2 KRU (Hidrodrini dhe Hidromorava) që kanë arritur performancë maksimale në shkallën e profitabilitetit, përderisa performancë të dobët kanë treguar KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica", rezultatet e të cilave ishin shpenzimet e larta operative dhe pamundësia e mbulimit të tyre nga të hyrat e faturuara. Performanca e përgjithshme në këtë tregues është realizuar në nivelin 2.80%, nga total i mundshëm prej 5%.

Efienca e arkëtimit, aktualisht ndodhet në nivelin prej 6.85% pikë të arritur nga maksimalja prej 10% e ndarë për këtë tregues. Efienca e arkëtimit, vit pas viti është duke shënuar përmirësim, në dy vitet e fundit është shënuar një progres më i madh. Gati të gjitha KRU kanë shënuar përmirësime në vitin 2018 krahasuar me vitin paraparak 2017, me përjashtim të KRU "Bifurkacioni" e cila ka pas një rënie prej 0.2%. Normën më të dobët në shkallën e arkëtimit ende e ka KRU 'Mitrovica' edhe pse në raport me vitin 2017 është përmirësuar dukshëm. Progresi po tregohet të jetë shumë i vështirë, sidomos mbetet sfida përmirësimi i arkëtimit të konsumatorët e amvisërisë.

Raportimi rregullator- Kualiteti i të dhënave të raportuara është vlerësuar përmes procesit të auditimit/verifikimit bazuar në atë se sa praktikatat e KRU për mbajtjen e të dhënave përputhen me një grup të caktuar të kriterëve të notimit nga 'Udhëzuesi për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU'. Mesatarja e përgjithshme e këtij treguesi është në nivelin 4.62% nga totali prej 5%. Edhe më tej mbesin shqetësimet e ARRU në lidhje me besueshmërinë e disa të dhënave operative (prodhimi i ujit, presioni, reduktimi (pronat me furnizim të kufizuar). Baza e të dhënave financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve në përgjithësi mbahen në module softuerike të avancuara dhe këto të dhëna në përgjithësi kanë rezultuar të jenë më të besueshme.

Kompania me performancën më të mirë edhe në vitin 2018 vazhdon të jetë KRU 'Gjakova', e cila ka mbledhur 68.3% të pikëve, e pasuar nga KRU 'Prishtina' me 67.0%. Megjithëse performanca e tyre në vitin 2018 është më ulët në raport me vitin 2017, (KRU 'Gjakova' -2,1% dhe KRU 'Prishtina' -3.5%).

Përmirësime më të mëdha të performancës në vitin 2018 kanë arritur: KRU 'Hidrodrini' me 4.6%, KRU 'Bifurkacioni' me 4.0%, dhe 'Hidromorava' me 3.7%. Progres po ashtu, ndonëse i lehtë, kanë ndodhur edhe tek KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 1.5%, si dhe tek KRU 'Mitrovica' me 0.7%.

Analiza e rezultateve, tregon se këtë vite kemi parë një përshpejtim të përmirësimit të performancës në disa KRU, dallimi në mese të tyre, përjashtuar KRU 'Mitrovica', është duke u ngushtuar me hapa të shpejtë. Si shembull dallim në mesatare të performancës së: KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Gjakova', si rasti me i mirë, është me pak se 6.0%.

4. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Pjesa në vazhdim prezenton performancën e përbashkët të shtatë KRU-ve, në disa tregues të rëndësishëm. Treguesit e analizuar janë marrë për një periudhë pesë vjeçare me qëllim që të kemi një pasqyrë sa më të qartë rreth trendeve të zhvillimit të këtyre treguesve.

4.1. UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UPF

Prodhimi i ujit pasqyron vëllimin e ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në rrjet. Shifrat e prodhimit të ujit në fig. 29, shikohen në raport me shitjet dhe me humbjet e ujit, për periudhën 2014-2018.




Fig.29, Vlerat sasiore të prodhimit, faturimit dhe UPF

Gjatë pesë viteve të fundit, sasia totale e ujit të prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët nga KRU, ishte në rritje e vazhdueshme. Në total sasia e ujit të prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët në vitin 2018 është 157.7 mil.m³, kjo është për 3.5 mil.m³ më shumë se sa në vitin paraprak 2017. Rënie e lehtë e prodhimit ka ndodhur tek tri KRU (Hidroregjioni jugor, Hidrodrini dhe Hidromorava), të tjerat kanë rritur edhe më tej sasinë e prodhuar të ujit. Në përgjithësi, rritja e përgjithshme e prodhimit të ujit ishte për shkak të përfundimit të projekteve në sigurimin e kapaciteteve të prodhimit për të rritur sigurinë e furnizimit të rregullt dhe të cilat u financuan nga disa KRU, me mbështetje të institucioneve përgjegjëse vendore dhe komunitetit të donatorëve. Aktualisht kjo sasi e ujit të prodhuar, gjatë kësaj periudhe është masë e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve për furnizim të vazhdueshëm dhe njëkohësisht për të mbuluar edhe sasinë enorme të UPF.

Po ashtu edhe shitjet vëllimore të ujit kanë shënuar rritje për gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, mirëpo kjo rritje ishte më graduale me rreth 10.5 mil.m³. Aktualisht vlera sasiore e shitjeve është 66.2 mil.m³ dhe në raport me vitin paraprak ato janë më të larta për rreth 1.4 mil.m³.

Uji i pa faturuar nga ofruesit e shërbimeve të ujit mbetet një sfidë serioze për të gjitha KRU. Megjithëse në krahasim me vitin e mëparshëm, sasia e UPF është zvogëluar për rreth 1.6 mil.m³. Figura më sipër (fig.29, tregon trendin e UPF për gjatë 5 viteve të fundit. Jo vetëm nga viti 2014 por edhe me herët trendi i UPF, ka pasur një rritje (përkeqësim).

Që moti ka ekzistuar nevoja për të identifikuar arsyet prapa kësaj rritjeje dhe adresimin e tyre dhe që nga ky vit (2018) të gjitha KRU kanë hartuar planet strategjike dhe janë duke zbatuar planet individuale të veprimit për zvogëlimin e UPF. ARRU do të vazhdojë të monitorojë shumë ngushtë zhvillimet në këtë drejtim. Ne jemi duke punuar me KRU që të zbatojnë Modulin e Bilancit të Ujit, si një mjet thelbësor për vlerësimin dhe identifikimin e sasisë së ujit të UPF.

4.2. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME

Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (kanalizim), paraqet përqindjen e popullsisë që shërbehet nga lidhjet shtëpiake individuale në sistemin e furnizimit të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit.




Fig.30. Mbulueshmëria me shërbime

Në zonën e shërbimeve të KRU vlerësohet së jetojnë një popullatë mbi 1.8 mil. njerëz, prej të cilëve mbi 1.7 mil. njerëz apo 97% marrin shërbime të sigurt të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullatës vendore llogaritet të jetë në zonat kryesisht rurale të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo edhe sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ana e KRU. Me shërbime të ujërave të ndotura janë rreth 1.4 mil. njerëz apo 77% e tyre.

Mbulueshmëria me shërbime ka shënuar përmirësime të vazhdueshme gjatë viteve. Mesatarja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit arriti në nivelin 97%, që është më e lartë për 13% në raport me vitin 2014, përderisa mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura është në nivelin 77%, dhe në këtë periudhë pesë vjeçare është rritur për 15%.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve në vitin 2018 është 355,030 me një rritje prej 16,876 konsumatorë në raport me vitin paraprak 2017. Numri i konsumatorëve shtëpiak është rritur për 15,346 përderisa për ata jo shtëpiak (komercial-Industrial dhe institucione) për 1,530 konsumatorë.

Tab11, Norma e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime për periudhën 2014-2018

Mbulueshmëria me shërbime	Ujësjellës	Ujëra të ndotura (kanalizim)
2014	84%	62%
2015	87%	65%
2016	91%	69%
2017	94%	74%
2018	97%	77%

4.3. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA, QARKULLIMI DHE PARAJA E GATSHME E ARKËTUAR

Qarkullimi nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Figura 31, tregon efikasitetin mesatar të qarkullimit dhe inkasimit gjatë 5 viteve dhe jep një pasqyrë më të qartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve, duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.




Fig. 31. Performanca financiare e sektorit

Efiçienca e Qarkullimit⁷ në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2018 ka shënuar një përmirësim të lehtë, dhe atë për 444 mijë € apo shprehur në përqindje për 1% në raport me vitin 2018. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet zgjerimit të bazës së konsumatorëve vit pas viti, e më pas edhe ngritjes së efikasitetit të të ardhurave nga faturimi. Qarkullimi në vitin 2018/2014, në vlerë monetare është përmirësuar për 5.5 mil. €, apo shprehur në përqindje 19%.

Për dallim nga Efiçienca e qarkullimit, Efiçienca e arkëtimit në vitin 2018 në raport me vitin 2014, ka shënuar përmirësim dukshëm me të lartë dhe atë prej 9.9 mil.€, apo shprehur në përqindje për 46%, përderisa krahasuar me vitin paraparak 2017 është ngritur në nivelin prej 10%.

Shkalla e arkëtimit në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2018 ishte 92% apo 8% më e lartë, krahasuar me vitin 2017, përderisa krahasuar me vitin 2014 shkalla e arkëtimit është me e lartë për 17%.

Tabela 12. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2014	29,296,792.70	21,890,722.67	75%
2015	32,125,817.68	23,969,835.35	75%
2016	32,980,466.89	28,486,856.51	86%
2017	34,183,538.19	28,693,881.87	84%
2018	34,627,728.80	31,685,606.76	92%

Niveli prej 92% i Efiçencës së arkëtimit mund të themi se është i kënaqshëm, meqenëse vetëm 8% e borxheve nga konsumatorët mbetet pa u inkasuar. Edhe pse trendi i inkasimit është në rritje e sipër kompanitë prapë nuk kanë arritur nivelin e duhur prej 100%, dhe një rritje të tillë të inkasimit ata mund ta realizojnë përmes aplikimit të ndërprerjeve të shërbimeve të ujit, adresimit të mbledhjes së tyre përmes përmbartuesve privat, dhe aktivizimi i inkasantve mobil i cili aktivitet po vërehet që po ka shumë sukses.

4.4. SHPENZIMET KAPITALE PËR FURNIZIM ME UJËSJELLËS DHE SHËRBIME TË UJËRAVE TË NDOTURA

Ky seksion paraqet analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifor 2 (2012-2014), 3 (2015-2017) i cili ka përfunduar, dhe procesit aktual 4 (2018-2020).

Është e qartë se financimi drejt sektorit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ka nevojë për mbështetje dhe përpjekje të bashkërenduara nga akterë të ndryshëm. Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor,

⁷ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete e tjera operative,

Keshi ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe kanalizimit si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative.

ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime, sidomos në trajtimin e ujërave të ndotura.

Nga të gjitha KRU, pritet që të realizojnë investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujësjellës dhe në shërbimin e ujërave të ndotura dhe nga totali i shumës së planifikuar për procesin tarifor (2018-2020) konkretisht për vitin 2018, prej afro 37 milion €, me një ndarje të njëjtë prej 1/2 ose 50% në furnizim me ujësjellës dhe 1/2 ose 50% në shërbimin e ujërave të ndotura. Nga mjetet vetanake të KRU është planifikuar të investohen rreth 3.6 milion € shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura).

Tab.13, Vlera totale e shpenzimeve kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura

Kompania	2014	2015	2016	2017	2018
KRU 'Prishtina'	1,592,704	964,011	750,874	41,056,736	12,685,320
KRU 'Hidroregjioni Jugor'	909,195	1,154,620	1,185,597	226,616	284,104
KRU 'Hidrodrini'	802,008	2,034,939	243,840	589,753	395,489
KRU 'Mitrovica'	0.00	-	8,377,055	12,376,814	1,363,929
KRU 'Gjakova'	1,166,757	1,310,426	2,140,844	1,251,808	7,428,122
KRU 'Bifurkacioni'	3,060,203	279,182	156,414	216,652	13,477
KRU 'Hidromorava'	1,971,971	204,840	118,783	38,030	570,565
Totali	9,502,839	5,948,018	12,973,406	55,756,409	22,741,006

Vlera e investimeve përgjatë këtyre 5 viteve ka qenë rreth 107 milion Euro, mjete të investuara kryesisht nga donatorët, si dhe një pjesë e vogël nga KRU. Në raport me vlerën e planifikuar realizimi i investimeve arrin në nivelin prej 56%.

Nga shuma e përgjithshme gjatë këtyre 5 viteve rreth 57 mil. Euro janë realizuar nga KRU "Prishtina", përderisa me pak shpenzime kapitale janë realizuar në KRU "Hidromorava"(2.9 milion Euro).

Këto investime kryesisht kanë pasur për synim: përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit, cilësinë e ujit, si dhe zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës. Pra janë rritur kapacitetet prodhuese të ujit në zgjerimin, mirëmbajtjen dhe përtrirjen e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Më shumë investime janë bërë në KRU 'Prishtina', 'Mitrovica', si dhe në KRU 'Gjakova'. Janë 4 projekte të mëdha që u nisën për të përmirësuar vazhdimësinë e furnizimit me ujë në këto tri kompani, dhe ato janë fabrikat e prodhimit të ujit të pijshëm në: Shkabaj, Shipol, Balincë dhe Radoniq.

Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime. Sektori i ujit (ujësjellës dhe ujëra të ndotura) ka nevojë për mbështetje të mëtejme investuese dhe përpjekje të bashkërenduara nga akterë të ndryshëm.

5. PERFORMANCA E N.H. “IBËR- LEPENCI”

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të N.H. ‘Ibër Lepenci’, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU ‘Mitrovica’ dhe KRU ‘Prishtina’.

Në vazhdim po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës, për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2018, në raport me vitin 2017.

Tab. 14, Të dhënat statistikore për N.H. ‘Ibër-Lepenci’

Të dhënat statistikore për 2017 / 2018	2017	2018
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	38,040,970	44,548,630
Faturimi për ujiin me shumicë (€)	965,859	1,052,904
Arkëtimi për ujiin me shumicë (€)	762,739	1,204,344
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	969,911	1,286,328
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	51	69

Në vitin 2018 është shënuar një rritje e sasisë së ujit dhe vlerës së faturuar, kryesisht dërguar tek KRU ‘Prishtina’, për nevoja të fabrikës së re, në Shkabaj.

Po ashtu janë rritur edhe shpenzimet për furnizimin e ujit me shumicë, si rezultat i rritjes së numrit të punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë, i ngritur për 18 sosh.

Në tabelën 13, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e N.H. ‘Ibër Lepenci’ gjatë vitit 2018/2017.

Tab.15, Treguesit e Performancës se N.H. ‘Ibër-Lepenci’

Treguesi i performancës	2017	2018
Shkalla e arkëtimit	79%	114%
Norma e punës	1.00	0.82
Norma e mbulimit të punës	0.79	0.94
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.03	0.03

N.H. ‘Ibër Lepenci’ ka shënuar progres në mbledhjen e të gatshmeve, në normën 114%, duket se ka arritur të arkëtoj edhe një pjesë të borxhit të mbetur nga vitet e kaluara, pra janë borxhe që i takojnë vitit 2015 dhe 2017.

Rritja e faturimit në euro nuk ka ndikuar që edhe norma e punës të jetë më e lartë krahasuar me vitin 2017, përkundrazi ajo ka rënë (përkeqësuar), nga 1.0 për 2017 në 0.82 në 2018, rezultat i të cilës rënie është rritja e shpenzimeve për 33%. Norma e mbulimit të punës edhe pse ka treguar përmirësim në raport me vitin 2017, kjo kompani prapë mbetet nën nivelin e dëshiruar për ti mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2018 për shërbimet e ofruara.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2018, kanë mbetur në nivelin e njëjtë me vitin 2017, rreth 0.03 €/m³.

6. AKTIVITETET E KKK

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) veprojnë në kuadër të zonave të shërbimit të mbuluara nga KRU respektive, me mandat ligjor të themeluara nga/në kuadër të ARRU-së, për të përfaqësuar interesat dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve të cilat nuk janë trajtuar në pajtim me dispozitat ligjore, nga ofruesi i tyre i shërbimeve. Ato funksionojnë në shtatë rajone të Kosovës, ku secila komunë brenda rajonit të përcaktuar e ka përfaqësuesin e vet në kuadër të KKK respektive në atë regjion. ARRU edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar në fuqizimin dhe ngritjen e profilit të tyre, duke i mbështetur me ndihmën profesionale lidhur me punën dhe detyrat e tyre.

Komisioni Këshillues i Konsumatorëve ka mbajtur 92 takime në të gjitha rajonet për çdo muaj. Takimet e KKK kanë qenë të hapura për publikun ku në shumicën e rasteve kanë marrë pjesë konsumatorët. Ka marrë pjesë po ashtu edhe nga një përfaqësues i Kompanive Rajonale të Ujësjellësit dhe zyrtari përgjegjës i ARRU. Në këto takime janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve por edhe janë diskutuar dhe debatuar edhe shumë çështje të rëndësishme për konsumatorin (standardet e shërbimit, tarifat, ndryshim-plotësimi i akteve nënligjore të ARRU-së, performanca e Kompanive, etj.).




Fig. 32. Numri i ankesave të parashtruara 2017-2018

Në vitin 2018 gjithsejtë janë parashtruar 319 ankesa për të gjitha KKK, kjo është për 53 ankesa më shumë se sa ishin deponuar në vitin 2017. Më shumë ankesa vazhduan të adresohen në KKK për regjionin e Prishtinës (62%), Gjakovës (15%), si dhe Ferizajt (14%), zona të shërbimit të mbuluara nga KRU 'Prishtina' 'Gjakova' dhe KRU 'Bifurkacioni'.

Konsumatorët në shumicë janë ankuar për çështjet komerciale: kontestim i borxhit, zbritja/shlyerja e borxhit, faturimi paushall, mos leximi i rregullt i ujëmatësve, por edhe një pjesë e konsiderueshme janë ankuar në aspektin teknik (standardeve të shërbimit).

Rreth 273 ankesa kanë qenë të adresuara nga konsumatorët e amvisërisë, 44 nga konsumatorët komercial –industrial dhe vetëm 2 ankesa janë nga Institucionet.

Vlenë të theksohet se të gjitha ankesat e konsumatorëve të dorëzuara si në kutitë e ankesave dhe në zyrën e pranimit në ARRU, janë shqyrtuar sipas ligjeve në fuqi dhe janë respektuar afatet kohore për t'iu përgjigjur në ankesat apo kërkesat e konsumatorëve.

Nga të gjitha këto ankesa, 278 janë të zgjidhura, 10- njoftim për palën, 10- të palejuara, 17- pa afat, 0- lënda në gjykatë, 4-të tjera.

7. SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit, çdo vit prezanton sfidat dhe shqetësimet më të mëdha të sektorit të shërbimeve të ujit në vend nga perceptimi rregullator. ARRU ofron gjithashtu të dhëna kyçe, sugjerime dhe analiza për të ndihmuar në mbështetjen e zhvillimit dhe zgjidhjeve të duhura. Për këtë vit ne kemi specifikuar disa nga sfidat më aktuale me të cilat ballafaqohen KRU dhe sektori i ujit në përgjithësi. Si të tilla këto çështje të veçanta e të listuara më poshtë kërkojnë që ndërmarrjet e shërbimeve të ujit dhe institucionet vendore përgjegjëse të jenë proaktive dhe jo reaktive, me qëllim të menaxhimit sa më të mirë dhe më të lehtë të tyre.

Mirëmbajtja e infrastrukturës

Kjo është një sfidë tjetër në industrinë e shërbimeve të ujit, në vargun e shumë sfidave të cilat po e përcjellin sektorin e shërbimeve të ujit në Kosovë, në këtë drejtim kompanitë po veprojnë në zonë të kuqe, në mungesë të mjeteve financiare të nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës ekzistuese. Normat e larta të UPF sidomos të komponentës së humbjeve fizike arsyetohet edhe me faktin se norma e defekteve në mesatare të sektorit (208/ 100 km), është një normë e lartë dhe si e tillë edhe shumë largë normave aktuale të vendeve evropiane. Po ashtu treguesi më i rëndësishëm i performancës së infrastrukturës së furnizimit, janë ndërprerjet e shpeshta të shërbimeve për shkakun e plasjeve të gypave të furnizimit, apo edhe defektet-bllokimet e rrjetit të kanalizimeve.

Rëndësia e infrastrukturës dhe mirëmbajtja e rregullt e saj qëndron në mbështetjen dhe cilësinë e shërbimeve të qëndrueshme dhe të besueshme të shërbimeve të ujit. Është e qartë se, për të arritur qëllimin e saj, infrastruktura duhet të operohet dhe mirëmbahet në mënyrë efektive. Dështimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës me kohë ka pasoja për ndërprerjen e vazhdimin të shërbimit, si dhe kosto të lartë të punës dhe riparimit, sikur ajo të ishte ndërmarrë në kohë. Mirëmbajtja e infrastrukturës duhet të konsiderohet si një mjet strategjik për të nxitur ofrimin e shërbimeve më të mira. Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese nuk duhet të shihet si e një rëndësie dytësore në perspektivën më tërheqëse të infrastrukturës së re, por duhet të bëhet në vazhdimësi dhe vit pas viti. Kjo vjen me një kosto, por ky është një investim i kujdesshëm i cili do të kursojë KRU në mënyrë të konsiderueshme në afat të mesëm dhe afatgjatë dhe do të promovojë shërbime eficiente.

Kostoja e mirëmbajtjes së aseteve të infrastrukturës është shumë e përcaktuar jo vetëm nga madhësia, natyra, kapaciteti i asaj infrastrukture, por edhe nga sa është projektuar, materialet e specifikuar dhe të përdorura, cilësia e ndërtimit, etj. Në përgjithësi të paktën gjysma e koston së jetës për një aset të infrastrukturës duhet të bartet pas kryerjes së tij. Me fjalë të tjera kostoja e planifikimit, projektimit dhe ndërtimit të asetit është pa mëdysheje më pak se gjysma, nganjëherë edhe më pak se 20% e koston së jetës së shfrytëzueshme të asetit.

Vendimi për prokurimin e infrastrukturës duhet të udhëhiqet nga kuptimi i kostove të ciklit jetësor të asaj infrastrukture. Ajo duhet të marrë parasysh jo vetëm periudhën relativisht të shkurtër të projektimit dhe ndërtimit, por edhe periudhën shumë më të gjatë të operimit dhe shpenzimeve më të mëdha të operimit. Menaxhimi i infrastrukturës gjatë ciklit jetësor do të thotë të shqyrtohen mundësitë dhe strategjitë, kostot gjatë gjithë jetës së tij, e planifikuar për ta pasur në dispozicion. Në Kosovë ka ngecje në menaxhimin e aseteve në përgjithësi dhe në veçanti të infrastrukturës në mënyrë të planifikuar. Mirëmbajtja e aseteve dhe investimet kapitale në infrastrukturë në përgjithësi bëhen në baza ad-hoc, duke reaguuar ndaj nevojave urgjente, apo dështimeve të sistemit. Si pasojë e kësaj, baza e infrastrukturës vazhdon të përkeqësohet nga viti në vit. Me futjen e një qasje strategjike të menaxhimit të infrastrukturës, KRU mund të fillojnë të planifikojnë se si të ndryshojnë këtë rënie të vazhdueshme të performancës së infrastrukturës, duke kuptuar se çfarë është e nevojshme dhe se sa mund të kushtojë kjo. Analiza lidhur me mirëmbajtjen e infrastrukturës si pjesë e rëndësishme e menaxhimit të aseteve duhet paraqitur në PMA, i cili përdoret për të informuar Biznes Planin dhe Aplikacionin Tarifor për rregullatorin. Në këtë mënyrë ARRU mund të sigurojë që duke mos lënë anash edhe çështjet e përbalueshmërisë, që është përcaktimi i një tarife që reflekton koston e vërtetë të mirëmbajtjes së bazës së aseteve-infrastrukturës për të siguruar nivelet e kërkuara të shërbimit në mënyrë transparente dhe përgjegjshme, si dhe me kosto efektive.

Trajtimi i ujërave të ndotura

Kosova nuk ka sasi të mëdha të ujit të pijshëm dhe kjo që është, shfrytëzohet në mënyrë jo racionale, prandaj uji, si një burim me rëndësi strategjike, duhet të ketë trajtim adekuat – shfrytëzim racional, si dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme për ndërtimin e sistemeve bashkëkohore të trajtimit të ujërave të ndotura. Ujii ndotur ndot mjedisin dhe ka efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe është një çështje prioritare që kërkon zgjidhje urgjente.

Në Kosovë, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe trajtimi i duhur i ujërave të ndotura mbetet sfida kryesore për mjedisin. Kujtojmë se infrastruktura e kanalizimit nuk është ende e kënaqshme, pasi ende $\frac{1}{4}$ e popullsisë nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit. Rreth 157 mil.m³ e ujërave të ndotura shkarkohen çdo vit në lumenj nga KRU, duke rrezikuar në masë të madhe mjedisin dhe shëndetin e popullatës. Sasitë më të mëdha të ujërave të ndotura prodhohen nga konsumatorët shtëpiak. Sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura në vend, situata është alarmante. Aktualisht në Kosovë funksionon një ITUN në Skënderaj, menaxhuar nga KRU 'Mitrovica' dhe dy ITUN të vegjël të menaxhuar nga KRU 'Prishtina'. Sasia totale e ujërave të ndotura të trajtuara është vetëm rreth 1.0 mil. m³, në vit. Kjo është e pa krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian. Si duket kjo do të jetë edhe një nga sfidat më të mëdha në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, meqenëse standardet e vendosura për vendet Evropiane janë shumë të larta. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) të Komisionit Evropian, më 27 tetor 2015, vendi është një hap përpara drejtë anëtarësimit në BE. Kosova me këtë ka pranuar detyrimin për të harmonizuar të gjitha rregulloret, rregullat dhe procedurat me acquis të BE-së (rregulloret, direktivat, vendimet, etj). Për fushën e ujit është sigurisht dokumenti më i rëndësishëm juridik - Direktiva Kornizë e Ujit të Bashkimit Evropian (2000/60 / EC), i cili ndër të tjera ka përcaktuar objektivat për mbrojtjen e ujit, si pjesë e mjedisit. Direktivat e tjera në fushën e ujit, të cilat plotësojnë Direktiva Kornizë të Ujit, përcaktojnë standardet e cilësisë së mjedisit, trajtimit të ujërave të ndotura, llojet dhe kufizimet e substancave të rrezikshme, parametrat e standardeve të ujërave nëntokësore në varëshmëri të statusit të cilësisë së ujit për lloje të caktuara të përdorimit - ujë të pijshëm etj.

Trajtimi i ujërave të ndotura kërkon shumë para, por edhe shumë njohuri të cilat aktualisht nuk mund të përballen nga kapacitetet vendore. Sfida më e madhe për zbatimin e projekteve është sigurimi i burimeve të nevojshme financiare me kushtet më të favorshme për financimin e projekteve në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura. Kjo do të duhej arritur përmes fondeve me grand nga IPA, BB dhe fondet tjera në kuadër të marrëveshjeve bilaterale, me agjencionet zhvillimore dhe sigurisht edhe një pjesë nga buxheti i Kosovës. Mungesa e kapaciteteve profesionale në institucionet përgjegjëse, paraqet problem shumë serioz në përgatitjen dhe zbatimin efektiv të këtyre projekteve, por kapacitetet e pamjaftueshme profesionale janë evidente po ashtu edhe tek përdoruesit përfundimtarë KRU – gjatë operimit-zbatimi të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në përgatitjen dhe implementimin e projekteve duhet të marrin pjesë ekspert të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, duke rezultuar kryesisht me përgatitje të mirë të projekteve, si në: komponentët teknike, strukturën e financimit dhe bazën ligjore: përgatitjen e dokumentacionit teknik, përgatitjen e studimeve të ndryshme (të fizibilitetit, ndikim në mjedis), analizën ekonomike-financiare dhe institucionale, marrjen e lejeve të nevojshme, çështjet për zgjidhjen e pronës, përgatitja e procedurave të prokurimit publik), si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të vendit për zbatimin e acquis të BE-së në fushën e ujit. Struktura e stafit ekzistues në institucione dhe KRU për menaxhimin e ujërave të ndotura po ashtu duhet të forcohet. Për qëllimin afatgjatë dhe planifikimit efektiv të projekteve të ujërave të ndotura është e nevojshme për të krijuar bashkëpunim të drejtpërdrejtë, të vazhdueshëm dhe koordinimin e gjithë palëve të interesit, fillimisht mes pjesëmarrësve në bashkëfinancimin e projekteve për trajtimin e ujërave të ndotura, si dhe institucioneve dhe KRU të cilat do të menaxhojnë me këto sisteme. Duhet pasur në konsideratë që kostoja e shërbimit për qytetarët, ti përshtatet kushteve socio-ekonomike. Politika ekzistuese tarifore për ujë dhe ujëra të ndotura në formën aktuale, është e përcaktuar në "tarifat uniforme për shërbimet e ujit dhe ujërat e ndotura për të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e kanalizimit të Kompanisë Rajonale të Ujit". ARRU është duke shqyrtuar mundësinë e gjetjes së politikave tarifore më të drejta në këtë shërbim, duke u bazuar në parimin ndotësi paguan dhe në përbalueshmërinë për të paguar faturat nga ana e konsumatorëve.

SHTOJCA 1: KUALITETI I TË DHËNAVE

Ky Raport është hartuar duke i shfrytëzuar të dhënat të cilat i kanë raportuar kompanitë publike të licencuara të ujit në pajtim me obligimet e tyre raportuese të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe me licencat e shërbimit. Të dhënat për kualitetin e ujit ARRU i ka marrë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK), me të cilin ARRU ka Marrëveshje të Bashkëpunimit.

Të dhënat e raportuara nga kompanitë konform sistemit të raportimit të cilin e ka zhvilluar ARRU (Raporti vjetor dhe sistemi ROFK), i janë nënshtruar auditimit/verifikimit të cilin e ka ndërmarë ARRU gjatë muajit Prill 2019. Qëllimi i auditimit ka qenë që të verifikohet kualiteti i të dhënave, respektivisht saktësia dhe besueshmëria e tyre. Auditimi ka konsistuar në krahasimin e të dhënave të raportuara me të dhënat faktike në sistemin informativ të kompanive, si dhe në vlerësimin e besueshmërisë së tyre. Në përgjithësi ARRU i konsideron të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport (përpos të dhënave që kanë të bëjnë me aspektet operative dhe disa të dhëna nga shërbimi ndaj konsumatorëve), kryesisht të besueshme dhe korrekte.

Vlerësimi i besueshmërisë së të dhënave është bazuar në kriteret e dhëna në: “udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU”. Për më tepër, ARRU këtë vit ka ndërmarë edhe aktivitete tjera në këtë drejtim siç janë: (i) Vlerësimi i progresit në zhvillimin e sistemeve të monitorimit” si dhe azhurnimin e dy dokumenteve të rëndësishme si: “Moduli i inspektimit të standardeve dhe kushteve tjera të licencës” - 2018 si dhe “Moduli i Balancit të ujit-2018, dhe të cilat krahas aktivitetit të auditimit, kanë qenë bazë e mirë e konstatimit të nivelit të besueshmërisë së të dhënave për vitin 2018.

Në aspektin e besueshmërisë dhe saktësisë, të dhënat janë vlerësuar në 3 kategori, të specifikuar me nota-norma korresponduese: (i) Të besueshme -100%, (ii) Pjesërisht të besueshme – 50% dhe (iii) Jo të besueshme-0

Çdo e dhënë e raportuar është vlerësuar nga ekipi i auditimit, bazuar në atë se sa praktikatat e KRU përputhen me një grup të caktuar të kriterëve të notimit, nga udhëzuesi për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU. Rezultatet e besueshmërisë së ulët të të dhënave zakonisht tregojnë me shumë vlerësime, ndërsa rezultatet sa më të larta tregojnë: mirëmbajtje të shënimeve, matje të sakta dhe menaxhimi i informacioneve me sisteme softuerike-automatike (telemetrisë) apo edhe formate të raporteve të sakta dhe të verifikueshme.

Të dhënat para finalizimit janë qarkulluar tek të gjithë ofruesit e shërbimeve për konfirmim se të dhënat janë korrekte dhe eventualisht emetimin e ndonjë gabimi të mundshëm teknik.

Përfundimet e nxjerra nga analiza e sistemit të informacioneve të KRU, në kontekst të mundësisë së gjenerimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme, në detaje janë dhënë në raportet e auditimit/verifikimit të të dhënave. Në këtë raport kemi paraqitur një përmbledhje të përgjithshme të të gjeturave nga vlerësimi i cilësisë së të dhënave me komente përcjellëse.

Sistemi softuerik, në tërësi i integruar për menaxhimin e informacioneve, aktualisht nuk është në nivel të kënaqshëm. Sa i përket aplikacioneve financiare, ato janë mirë të zhvilluara në të gjitha KRU. Vetëm tri KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, ‘Bifurkacioni’ dhe ‘Gjakova’, kanë module të avancuara për marrëdhënie me konsumatorë dhe janë mirë të përditësuara. Aplikacionet e SIG janë të instaluar në të gjitha KRU, megjithëse KRU ‘Hidrodrini’ dhe ‘Hidroregjioni Jugor’ kanë një përditësim dhe përfshirje më të madhe të këtyre sistemeve në aspektet operative të kompanisë.

Hapësirë të dëshirueshme në të gjitha KRU lenë sistemi on-line i monitorimit të sistemit të furnizimit me ujë. Sistemi SCADA në rrjetin shpërndarës dhe ITU është në një masë e zhvilluar vetëm në KRU ‘Mitrovica’. Në kompanitë e tjera është po thuajse inekzistent, përderisa sistemin SCADA në ITU e kanë të instaluar plotësisht vetëm KRU ‘Mitrovica’. Në KRU e tjera ai është pjesërisht i plotë (Prishtina, Hidromorava dhe Bifurkacioni). Një gjendje e tillë e sistemit të menaxhimit të informacioneve, paraqet vështësi si në regjistrimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për kompanitë, e po ashtu edhe për rregullatorin gjatë procesit të auditimit/verifikimit të të dhënave të raportuara.

Besueshmëria e të dhënave, Mesatarja e përgjithshme e besueshmërisë së të dhënave të raportuara në vitin 2018 është në nivelin prej 92%, aq sa ishte edhe në vitin 2017. Pak përmirësime janë vërejtur tek të dhënat jo financiare-ujësjellës (1%) përderisa më tepër është përmirësuar besueshmëria e të dhënave jo financiare-ujëra të ndotura (5%), kjo për faktin se personat përgjegjës nga kompanitë i kanë kuptuar më mirë definicionet dhe kanë pasur më tepër qartësi gjatë azhurnimit dhe raportimit të këtyre të dhënave. Të dhënat financiare në përgjithësi mbesin në nivel më të lartë të besueshmërisë (94%). Disa defekte edhe këtë vit janë vërejtur tek raportimi i zërave të shpenzimeve, gjegjësisht ndarjeve në shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura. Tek disa KRU ka pasur një rënie të lehtë të besueshmërisë së të dhënave, kjo e ndikuar nga fakti se zyrtaret përgjegjës gjatë auditimit kanë pasur një pasqyrë më të qartë të përmbushjes së kriterëve, duke u bazuar në aktivitetet e ndërmarra në këtë drejtim nga ana e ARRU në vitin 2018.

Vlera përfundimtare mesatare e besueshmërisë së të dhënave për KRU është: me e larta në KRU Gjakova (97%), përdërisa me e ulët është në KRU 'Mitrovica' 88%.

Tab. 16, Kualiteti i të dhënave të raportuara (2017-2018)

KRU	Të dhënat, jo financiare-ujësjellës		Të dhënat, jo financiare-ujëra të ndotura		Të dhënat financiare, ujësjellës dhe ujëra të ndotura		Mesatarja e përgjithshme -KRU	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjakova	92%	93%	89%	89%	100%	98%	98%	97%
Hidromorava	88%	90%	95%	87%	100%	98%	98%	96%
Prishtina	85%	85%	79%	84%	99%	98%	96%	95%
Bifurkacioni	88%	90%	84%	95%	92%	92%	91%	92%
Hidroregjioni Jugor	87%	82%	87%	92%	92%	91%	91%	90%
Hidrodrini	84%	89%	58%	63%	88%	92%	85%	89%
Mesatare e sektorit	87%	88%	78%	83%	94%	94%	92%	92%

Rekomandime të përgjithshme, rreth përmirësimit të besueshmërisë së të dhënave, dalin nga rezultati i të gjeturave nga procesi i auditimit/verifikimit të të dhënave. Me zbatimin e këtyre rekomandimeve KRU me siguri do të avancojnë sistemin e tyre të mbajtjes, menaxhimit dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara, ashtu siç tregohet edhe në 'Udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe KRU', duke:

- Avancuar edhe më tutje sistemin e regjistrimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, në një sistemi integruar elektronik të monitorimit, për të shfrytëzuar dhe gjeneruar në mënyrë efektive informacionet e duhura,
- Instaluar ujëmatësit në të gjitha vendburimet e prodhimit të ujit, duke zëvendësuar dhe testuar ujëmatësit e vjetërsuar / të dëmtuar,
- Bërë testimin volumetrik të ujëmatësive zonal, si dhe ujëmatësive të konsumatorëve sipas kërkesave ligjore, dhe nevojave për të konfirmuar saktësinë e matjes. Rezultatet e testimit të ruhen të dokumentuara për tu përdorur për analizën dhe menaxhimin e humbjeve të ujit,
- Vendosur sistemin e kontrollës dhe mbikëqyrjes SCADA (ose një sistem të ngjashëm kompjuterik të monitorimit), për kontrollin e ujit të trajtuar dhe kontrollin e ujit të shpërndarë në tërë sistemin e trajtimit dhe shpërndarjes së ujit dhe për tërë zonën e shërbimit të kompanisë,
- Vendosur programin e menaxhimit të presioneve, me pajisje të mjaftueshme (manometra), dhe instaluar sistemin e mbikëqyrjes, kontrollit dhe matjes (SCADA), për të matur dhe siguruar të dhëna të besueshme dhe të shpërndara të presionit në tërë zonën e furnizimit dhe në rrjetin distributivë dhe shpërndarjes së ujit.
- Lidhur sistemin e Informacionit Gjeografik (SIG) dhe bazën e të dhënave të menaxhimit të asetëve (PMA) me sistemin e menaxhimit të mirëmbajtjes (SRM), si dhe duke i verifikuar këto të dhëna në teren.
- Instaluar sistemin e menaxhimit të projekteve, për të planifikuar, monitoruar dhe menaxhuar të gjitha fazat e projekteve kapitale në mënyrë që të shihet përmirësim në infrastrukturën e shërbimeve
- Instaluar sistemin e menaxhimit të mirëmbajtjes, për të siguruar përditësimin e databazës së defekteve në kuadër të këtij aplikacioni, e cila përmban informacione për të gjitha plasartjet dhe dëmet tjera që kanë ndodhur në rrjetin shpërndarës të ujit si dhe aspektet e lidhura me financat.
- Avancuar dhe përditësuar, sistemin e informacioneve financiare përmes përdorimit të Planit kontabël që përfshinë kërkesat rregullatore në kategorizimin e shpenzimeve operative sipas kostove qendrave.

Të dhënat dhe treguesit e detajuar të performancës, në përdorim plotësojnë të gjitha kërkesat e matjes së mirë dhe efektive të performancës për nevoja dhe qëllime të proceseve Rregullatore, institucioneve vendore me përgjegjësi vendimmarrëse në këtë sektor, informacione të vlefshme për donatorët, konsumatorët, ofruesit e shërbimeve dhe publikun e gjerë. Për nevoja të raportit kemi shfrytëzuar edhe të dhëna tjera të ofruara dhe të publikuara nga institucionet përgjegjëse siç është rasti me të dhënat e raportuara nga IKSHPK (kualiteti i ujit) apo Agjencioni i Statistikave të Kosovës (shkalla e inflacionit, statistikat e popullatës dhe ekonomive familjare).

Statistikat e detajuara të performancës së shtatë KRU janë të paraqitura në tabelat në vijim. Informatat e prezantuara janë të bazuara në dorëzimin e rregullt të raporteve në ARRU.

- të dhënat në lidhje me statistikat e popullsisë, numrin e konsumatorëve, gjatësinë e gypave, etj. nuk janë të dhëna të fund vitit, por janë mesatare të vlerësuara të vitit.
- të dhënat financiare të shprehura në EUR janë të përshtatura në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2017 (viti kur edhe janë përcaktuar tarifat tri vjeçare 2018-2020), e në përputhje me statistikat e publikuara të inflacionit për të mundësuar krahasimet e duhura nga viti në vit.
- të dhënat financiare janë raportuar në përputhje me “Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR)”, e në veçanti:
- përcaktimi i vlerës së asetëve është bërë sipas Bazës Rregullatore të Asetëve,
- mirëmbajtja kapitale është definuar si kombinim i ripërtëritjeve infrastrukturore dhe zhvlerësimit sipas kostos aktuale të asetëve jo-infrastrukturore,
- provizionimi i borxheve të këqija (shlyerja) janë të definuara si shuma të të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

KRU Prishtina (Prishtinë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2017	2018
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	99.9%	100%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	99.1%	98.9%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	81	22
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0.07%	0.02%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	85,310	113,015
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	77%	98%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	16,676	0
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	15%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	8,926	1,800
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	8%	2%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	29,757,221	32,728,713
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	652	692
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	679	695
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	57%	60%
	Plasarijtet e gypave	Frekuenca e plasarijtëve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasarijtet për muaj	114	154
		Plasarijtet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	72	98
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	110,912	114,815
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	117%	119%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	4,504	3,301
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	727	640
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	98%	98%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	100%	100%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	570	3,404
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	24	639
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranura (teknike)	W.2.C.01	Nr	3,607	2,723
		Ankesat e pranura (komerciale)	W.2.C.02	Nr	4,239	5,379
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	16,927,981	16,324,461
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	86%	94%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	762,413	692,967
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	N/A	91%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	4,621,711	4,807,250
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	77%	83%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	18,057	16,527
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	0%	82%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	8,331,383	8,536,069
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	91%	95%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	4,595,024	4,377,486
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	79%	83%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.049	0.050
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.055	0.059
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.430	0.545
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	0	5,311,301
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	1,712%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	0%	10%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	41,268,733	5,483,088

K- Ujërat e ndotura						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara	Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	3,321	3,892
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	304	356
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	18
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	1.65
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	95,695	99,503
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	101%	103%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të ndotura	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të ndotura në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	4,480	3,136
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	661	621
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	3,551	2,573
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	766,787	732,267
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	93%	97%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	489,298	495,017
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	76%	87%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.01	EUR/m ³	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.02	EUR/m ³	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	1.34	1.4
		Totali i koston për shërbime të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	1.47	5.9
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	1,672,549
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	605%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	21.3%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	221,666	218,382
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	1,874%	6,174%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	14,182,491	14,140,839
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	86%	91%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	12,478,659	13,736,878
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-1,597,793	-551,867
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	89%	96%
	Totali i të ardhurave të shlyera (faturimi-inkasimi i vitit paraprak)		F.1.B.04	EUR	1,049,876	1,703,832
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	7%	12%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	88%	97%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	5,92%	-0.15%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2017	2018
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	100%	99.7%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	100%	99.4%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	39,287	41,137
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	100%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	200	200
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	1%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	0	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	0%	0%
Shërbeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	10,115,569	9,690,479
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	612	561
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	612	562
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	58%	57%
	Plasritjet e gypave	Frekuenca e plasritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	257	243
		Plasritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	605	573
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	39,487	41,337
		Shtirja (konsumorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	70%	73%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	1,266	2,433
		Kycjet e reja (konsumorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	98	161
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	95%	96%
		Konsumorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	97%	98%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	543	720
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	66	23
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	1,417	1,037
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	1,048	580
Financiare						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,501,868	5,629,390
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	75%	90%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	679,994	515,166
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	262%	74%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,085,840	1,121,400
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	67%	88%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	99,154	81,857
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	29,776%	126%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,724,464	2,772,723
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	83%	91%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	1,034,469	946,157
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	77%	91%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.089	0.091
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.095	0.093
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.441	0.440
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	59,919	109,744
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	2%	7%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	0.8%	1.5%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	160,903	163,583
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	4.1%	3.0%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2017	2018
K- Ujërat e ndotura						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara	Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	1,215	1,140
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	450	422
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	77	61
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	29	23
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A	
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	34,747	37,156
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	62%	65%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të ndotura	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të ndotura në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	1,763	3,056
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	127	152
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranua (teknike)	S.2.B.01	Nr	558	511
		Ankesat e pranua (komerciale)	S.2.B.02	Nr	47	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	328,088	384,365
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	95.5%	90%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	128,143	191,069
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	72%	81%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.01	EUR/m ³	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m ³	S.3.B.02	EUR/m ³	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	10.75	11.47
		Totali i koston për shërbime të ujërave të ndotura për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	10.80	11.52
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	8,188	10,777
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	4,215,165	4,294,314
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	82%	90%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	3,988,366	4,109,732
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-220,110	-129,074
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	95%	97%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	539,806	226,799
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	13%	5%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	95%	96%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	6.55%	3.68%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
		Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionel/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidrodrini (Pejë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2017	2018		
W- Furnizimi me ujë								
Jo-financiar (teknik)								
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	100%	98.7%		
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	100%	100%		
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0		
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%		
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	40,282	41,421		
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	100%	100%		
